PËR MËSUESIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Elmaze Çitaku, Ardita Gashi

EDUKATË FIGURATIVE

Për klasën e dytë të arsimit fillor

2

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes 4
Hyrje 6
Planifikimi vjetor 14
Plani dymujor: shtator—tetor 15
Plani dymujor: nëntor—dhjetor 18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars 22
Plani tremujor: prill—maj—qershor 26
Mësimi 1: Krijoj me vija 30
Mësimi 2: Kudo në natyrë ka vija 32
Mësimi 3: Një botë plot me forma e figura 34
Mësimi 4: Mjetet e vizatimit 36
Mësimi 5: Piktura magjike me vija e mjete të ndryshme 38
Mësimi 6: Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta 40
Mësimi 7: Kontrasti i ngjyrave 42
Mësimi 8: Ngjyros me flamastera 44
Mësimi 9: Modelim i figurave gjeometrike dhe forma 3D 46
Mësimi 10: Krijoj figura gjeometrike me plastelinë 48
Mësimi 11: Krijoj figura simetrike 50
Mësimi 12: Modeloj kështjellën me plastelinë 52
Mësimi 13: Vula ose stampimi 54
Mësimi 14: Si të krijoj një libër? 56
Mësimi 15: Si të krijoj një poster? 58
Mësimi 16: Mjetet e shtypit dhe të disenjimit 60
Mësimi 17: Ilustrim përralle 62
Mësimi 18: Llojet e vijave në art 64
Mësimi 19: Rëndësia e vizatimit dhe përdorimi në praktikë 66
Mësimi 20: Vijat gjeometrike 68
Mësimi 21: Ngjyrat bazë dhe të përbëra 70
Mësimi 22: Ngjyrat e ujit ose akuarelet 72
Mësimi 23: Ngjyrat tempera 74
Mësimi 24: Krijoj kolazh me forma gjeometrike 76
Mësimi 25: Dalloj ngjyrat në pikturë 78
Mësimi 26: Format dhe strukturat 80
Mësimi 27: Unë do të bëhem 82
Mësimi 28: Komunikoj me të tjerët 84
Mësimi 29: Objektet dhe artefaktet e trashëgimisë kulturore 86
Mësimi 30: Shtatë mrekullitë e botës 88
Mësimi 31: Skica e planimetrisë 90
Mësimi 32: Krijoj me motive qilimi 92
Mësimi 33: Intitucionet kulturore 94
Mësimi 34: Krijuesit shqiptarë 96
Mësimi 35: Ekspozita e parë 98
Mësimi 36: Vlerësoj veprat e njohura 100
Mësimi 37: Punime impresioniste 102

UDHËRRËFYES
për konceptimin e mësimeve model

Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukimi figurative 2
Shkalla e kurrikulës: I **Klasa:** II
Tema: Vija dhe Vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh llojet e vijave dhe kupton përdorimin e tyre në vepra arti.
Përdorë lloje te ndryshme të vijave për të krijuar figura dhe objekte

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
1.3, II.4, III.1, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e vijave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton llojet të ndryshme të vijave
- Bën dallimin midis vijave të drejta ndaj vijave të lakuara
- Vizaton llojet e vijave me madhësi të ndryshme

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrimet me vija, figurat gjeometrike, fleta pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Matematika, Gjuhë komunikim, Njeriu natyra, Shoqëria njerëzit.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutim paraprak
Paraqiten disa ilustrime me vija të drejta, të lakuara, të ndërprera dhe disa ilustrime me forma gjeometrike dhe shkronja.
(Mund të përdoren edhe fotot nga libri.)

Paraqitrohen pyetje:
Çfarë vija po shihni? (të drejtaë lakuara etj.)
Si janë vizatuar katrori, trekëndëshi, rrethi? (Me vija të drejta dhe të lakuara, me njëqyn etj.)
Po shkronja "A" me çfarë vija është vizatuar? (Me vija të drejta.)

Vizatimi
Krijoj me vija

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.

Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Për t'i përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



Fletë pune
Dallo vijat dhe krijoj me to

1. Lidh llojet e vijave.
2. Vazhdo vizatimin sipas modelit.
3. Bashko pikat dhe krijo figurën.

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet që të krijojnë punimin e dëshiruar, duke përdorur vija të ndryshme.
Udhëzohen që t'i përdorin lapsat për vizatim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësitë vlerësohen me informata kthyese me gojë gjatë përgjigjeve që i japin për llojet e vijave si dhe gjatë diskutimeve për mjetet e vizatimit të llojeve të ndryshme të vijave etj.
Vlerësohen për vizatimet e vijave me shkrim me shenja motivuese (fytyra me emocione).

Detyrë:
Vizato një figurë sipas imagjinatës tënde.

Reflektim për rezultatin e orës mësimore:

Po shkronja "C" me çfarë vija është vizatuar? (Me vija të lakuara.)

Hapi 2: Nxënësitë dallojnë vijat e drejta, të lakuara dhe të ndërprera në tekst.
Nxënësitë bashkëbisedojnë rreth llojeve të vijave që gjenden në tekst.

Hapi 3: Paraqitrohet pyetja:
Me cilat mjete mund të vizatojmë vija të holla? Po vija të trasha?
Nxënësit japin përgjigjje duke i shikuar mjetet e vizatimit të vijave sipas trashësisë si vijave ná libër.

Hapi 4: Nxënësitë punojnë sipas udhëzimeve nó libër.

Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit, ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.

Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësuesit/et në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mësimit.

Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mësimit, udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe të rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe të programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënit: Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimit: Meqenëse nxënësit e klasë së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?

Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesit/et duhet të ndërtojnë mësimin mbi të mëparshmen dhe të kenë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët, sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehitë fillestare të nxënësve që të nxitet interesi i tyre për mësimin.
Pjesa kryesore e mësimit: Mësuesi/ja, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënit e mësimit përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese: figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimit kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

EDUKATË FIGURATIVE 2

Artet janë pjesë e kulturës dhe shërbejnë si mjete universale komunikimi e interpretimi të ideve e mesazheve dhe emocioneve individuale e kolektive. *Edukatë figurative 2* përfshin krijimtarinë artistike autoriale, por edhe elemente të trashëgimisë kulturore lokale, kombëtare e universale të manifestuar përmes kulturës, artefakteve, objekteve dhe krijimtarisë popullore (këngët, vallet, lojërat, legjendat, përrallat, mitet etj.).

Edukimi artistik u mundëson nxënësve që të kenë vizion, të planifikojnë dhe të caktojnë qëllime, të përcaktojnë metoda të ndryshme si t'i arrijnë ato qëllime, të identifikojnë alternativat, t'i rishikojnë ato, të zgjidhin probleme, të imagjinojnë, të punojnë në grupe dhe të zbatojnë vetëdisiplinë, durim, përqendrim, guxim dhe iniciativë. Me të gjitha këto veprime në fushën mësimore - Artet, nxënësit përdorin tërë potencialin e tyre njerëzor, emocional dhe krijues në mënyrë unike. Të mësuarit përmes arteve e mundëson një nivel të të menduarit më specifik, më krijues dhe më të avancuar, të bazuar në gjykim dhe imagjinatë.

Udhëzime metodologjike

Artet edukojnë në mënyrë të suksesshme për arritjen e kompetencave të parapara në kurrikulën e Kosovës, vetëm nëse gjatë mësimdhënies zbatohen në mënyrë të duhur parimet didaktike dhe metodike përkatëse në secilën prej lëndëve mësimore në fushën - Artet.

Metodologjia e mësimdhënies në lëndët artistike përfshin teknika dhe metoda mësimore specifike për zhvillimin e kompetencave artistike. Në këtë nivel duhet të përdoret kryesisht loja krijuese, intuita, mësimdhënia e integruar, e diferencuar (në bazë të prirjeve dhe të interesimeve individuale të nxënësit) si dhe qasja konstruktive e të nxënit me nxënësin në qendër. Përjetimi artistik, nxitja e kërshërisë, e ima-
gjinatës, liria e të shprehurit dhe inkurajimi i krijimtarisë janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe kur nuk mund t'i arrini ato,dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, ve-

primtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Burimi: Nga Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqe - me 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi/ja), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit (luajtja në role), këndimit apo vallëzimit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II.	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi/ja, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqe të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III.	Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi.

IV.	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V.	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si: shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarët.
2.	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënit të fushës së Arteve: Shkalla 1

I.	NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË
	1. Krijimtaria dhe performanca artistike Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj. **Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale:**
1.	Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.
2.	Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).
3.	Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.
4.	Imiton, reciton, interpreton role të thjeshta në dramatizim.
5.	Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.
6.	Përmes lojës imagjinon e krijon melodi, ritme, shoqërime, lëvizje e vallëzime në mënyrë të lirshme, origjinale dhe krijuese ose në temë të caktuar.

2.	Gjuha dhe komunikimi artistik
	Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim. **Nxënësi/ja:**
1.	Përmes përceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj., dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

3.	Relacioni art-shoqëri
	Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor. **Nxënësi/ja:**
1.	Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).
2.	Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale etj.).
3.	Emërton disa (së paku 4) krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.

4.	**Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik**
	Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike. **Nxënësi/ja:**
1.	Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
2.	Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. ai/ajo këndoi mirë, pastër, më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur, nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

II **QËNDRIMET DHE VLERAT** që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Kërshëria;
- Vetëbesimi;
- Dëshira për shprehje dhe komunikim në mënyrë të pavarur;
- Pjesëmarrja aktive;
- Shoqërimi;
- Bashkëpunimi;
- Respekti për veten dhe për të tjerët.

III. **AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese (Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë tingullore, të ngjyrave, të formave, të strukturave, të karaktereve, të lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Imagjinata dhe krijimtaria;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Shkathtësitë muzikore;
- Shkathtësitë lëvizore;
- Shkathtësitë shprehëse figurative;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathtësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe krijues.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Artet Klasa 2

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1 (Klasa II)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Edukatë figurative	Vizatimi Vija dhe vizatimi Ngjyra	Vizatimi Llojet e ngjyrave Ngjyrosje	Format dhe modelimi Gjurmët dhe shenjat Objekte dhe artefakte Ngjyrosje Komunikimi artistik	Galeri dhe ekspozime Profesioni im kur të rritem Analiza e punimeve Vlerësimi individual Projekte dhe shembuj Përshkrimi i punimeve	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 2,3,5,6,7,8 Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1,3,4,6,7,8 Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm 1,2,3,4,6,7 Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv 2,4,5 Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 3,5,7 Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 2,4,5,6
	9 orë	8 orë	9 orë	11 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Edukatë figurative

Fusha e kurrikulës: Artet **Klasa:** II

Tema mësimore:
- Vizatimi
- Vija dhe vizatimi
- Ngjyra

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë nje tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth gjysmë faqe - me rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale, apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
I.5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.
I.8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo performimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materiale të ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast të rrezikut.
II.7	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimin e ndërsjellë tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen) etj.
VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.3	Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.
2.1	Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) katalogë, kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj. dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.
3.2	Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale).
3.3	Emërton disa (së paku katër krijues, interpretues të njohur të gjinive dhe zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale dhe kombëtare).
4.1	Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje dhe mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
4.2	Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh ai/ajo këndon mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërku-rrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Vizatimi **Vijat dhe vizatimi** **Ngjyrat**	- RNF 1. Nxënësit marrin pjesë në aktivitete te ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale: vizatojnë, ngjyrosin, e modelojnë me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. - Përdor lloje të ndryshme të vijave për të krijuar figura e objekte. - Vizaton peizazhe duke përdorur vijat dhe format e tyre. - Vizaton së paku një punim me pamje nga flora e fauna. - Analizon hapësirat e brendshme dhe të vizatojë së paku 1 vizatim në hapësirë të tillë (klasë-shtë-pi-forma gjeometrike etj.). - Njeh dhe përdor mjete të vizatimit (laps, lapsa me ngjyrë, pastela, flamastera. - Identifikon ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta dhe efektet e tyre. - Përdor ngjyra dhe teknika të ndryshme për ngjy-rosjen e dy peizazheve. - Krijon kontrast ngjyrash në punime dhe dallon parimet bazë me shembuj. - Përvetëson ngjyrosjen me ngjyra lapsi e flamastera dhe ngjyros së paku 2 punime; - Kupton teknikën e akuarelit dhe ngjyros së paku 2 punime (me ngjyra uji). - Njohja dhe përdorimi praktik i mjeteve të - ngjyrosjes (lapsa me ngjyrë, flamastera, ngjyra uji, pastel, penel etj.	1. Krijoj vija 2. Kudo në natyrë ka vija 3. Një botë plot me forma 4. Mjetet e vizatimit 5. Piktura magjike 6. Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta 7. Kontrasti i ngjy-rave 8. Ngjyrosi me fla-mastera 9.	8	Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompe-tencave; Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar; Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar. Metodat: Ilustrimi; Demostrimi; Bashkëbisedimi. Teknikat: Stuhi mendimesh; Kllaster; Punë e drejtuar; Krijim i lirë; Harta e mendjes; Turi i galerisë.	Vlerësim i vazhdue-shëm; Vlerësim i ndërsjellë; Vlerësim individual; Pjesëmarrja në aktivitete; Ushtrime kontrolluese; Lista kon-trolli; Portfolio.	- Gjuhë amtare; - Matematikë - Njeriu dhe natyra; - Shkathtësi për jetë; - Shoqëria dhe mjedisi - Edukatë fizike, sportet dhe shën-deti; - Shoqëria dhe mjedisi - Ndërlidhja me çështje ndërkurri-kulare dhe situatat jetësore: - Edukimi për qytet-ari demokratike; - Edukimi për paqe; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	Edukatë figurative 2.

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Edukatë figurative

Fusha e kurrikulës: Artet **Klasa:** II

Tema mësimore:
- Vizatim
- Llojet e ngjyrave dhe teknikat e tyre
- Forma dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë nje tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth gjysmë faqe - me 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para tjerëve.
I.8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo performimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materiale të ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast të rrezikut.
II.7	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në familje (si p.sh. besimin e ndërsjellë tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen) etj.
VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.3	Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.
2.1	Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj. dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.
3.2	Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër muze, sallë koncertale).
3.3	Emërton disa së paku katër krijues, interpretues të njohur të gjinive dhe zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale dhe kombëtare.
4.1	Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje dhe mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
4.2	Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. Ai ai/ajo këndon mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Vizatim **Llojet e ngjyrave dhe teknikat** **Forma dhe modelimi**	- RNF 1. Nxënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale: vizatojnë, ngjyrosin, e modelojnë me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. - Njeh dhe përdor mjete të vizatimit (laps, lapsa me ngjyrë, pastela, flamastera. - Identifikon ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta dhe efektet e tyre. - Përdor ngjyra dhe teknika të ndryshme për ngjyrosjen e dy peizazheve. - Krijon kontrast ngjyash në punime dhe parimet bazë me shembuj. - Përvetëson ngjyrosjen me ngjyra lapsi e flamastera dhe ngjyros së paku 2 punime. - Kupton teknikën e akuarelit dhe ngjyros së paku 2 punime (me ngjyra uji). - Njohja dhe përdorimi praktik i mjeteve të ngjyrosjes (lapsa me ngjyrë, flamastera, ngjyra uji, pastel, penel etj). - Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale). - Arrin konkretizim modelimin e një figure gjeometrike me materiale të thjeshta modelimi. - Krijon figura simetrike me letër dhe materiale të tjera praktike. - Krijon një kështjellë me plastelinë sipas ndonjë tregimi popullor. - Njeh dhe përdor mjete të modelimit me mjete të lehta aplikuese (plastelinë, letra, tekstil etj.).	9. Modelimi figurave gjeometrike dhe forma 3D 10. Krijo figura gjeometrike me plasteline 11. Krijoj figura simetrike - Kolazhi 12. Modeloj kështjellën me plastelinë 13. Vula stampimi 14. Si të krijoj një libër? 15. Si të krijoj një poster? 16. Mjetet e shtypit dhe disenjimit	8	Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave; Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar; Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar. Metodat: Ilustrimit; Demonstrimit; Bashkëbisedimit. Teknikat: Stuhi mendimesh; Kllaster; Punë e drejtuar; Krijim i lirë; Harta e mendjes; Turi galerisë.	Vlerësim i vazhdueshëm; Vlerësim i ndërsjellë; Vlerësim individual; Pjesëmarrja në aktivitete; Ushtrime kontrolluese; Lista kontrolli; Portfolio.	- Gjuhë shqipe; - Matematikë; - Edukatë figurative; - Njeriu dhe natyra; - Shoqëria dhe; mjedisi; - Shkathtësi për jetë; - Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. - **Çështjet ndërkurrikulare:** - Të drejtat e fëmijëve; - Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë figurative 2.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	- Njeh llojet e vijave dhe të kupton përdorimin e tyre në vepra arti. - Kupton rëndësinë e vizatimit dhe përdorimin në praktikë (p.sh. filmat e vizatuar, ilustrimet në libra, arkitektura e qytetit etj.). - Tregon së paku 2 shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të vijave të lira ose gjeometrike (orenditë e brendshme dhe në natyrë). - Identifikon ngjyrat bazë dhe përzierjen e ngjyrave të dyta. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave të ujit, akuarel, tempera. - Krijon një kolazh me format gjeometrike dhe - diskuton mënyrën e realizimit.						

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Edukatë figurative

Fusha e kurrikulës: Artet **Klasa:** II

Tema mësimore:
- Format dhe modelimi
- Gjurmët dhe shenjat
- Vija dhe vizatimi
- Llojet e ngjyrave dhe teknikat e tyre

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë nje tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth gjysmë faqe - me 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para tjerëve.
I.8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo performimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materiale të ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast të rrezikut.
II.7	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimin e ndërsjellë tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen) etj.
VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.3	Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.
2.1	Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj. dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.
3.2	Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale).
3.3	Emërton disa, së paku katër krijues, interpretues të njohur të gjinive dhe zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale dhe kombëtare.
4.1	Shpreh reagimin personal emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje dhe mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
4.2	Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. Ai/ajo këndi mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare: dhe situatat jetësore	Burimet
Format dhe modelimi **Vija dhe vizatimi** **Llojet e ngjyrave dhe teknikat e tyre** **Gjurmët dhe shenjat**	- RNF 1. Nxënësit marrin pjesë në aktivitete te ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale. - Vizatojnë, ngjyrosin, e modelojnë me laps, me ngjyra, me plastelinë, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar. - Përdor materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale). - Arrin konkretizim modelimi të një figure gjeometrike me materiale të thjeshta modelimi. - Njeh dhe përdor mjete të modelimit me mjete të lehta aplikuese (plastelinë, letra, tekstil etj.). - Kupton artin e shtypit të thjeshtë dhe riprodhimin grafik në shtypshkronjë, p.sh. vula, shtypi me kompjutër, libri, posteri, etj. - Realizon një ilustrim sipas një shkrimi që ka lexuar. - Disenjon një poster me temën "Vendi im i bukur!". - Njeh shenjat (në rrugë, në TV, etj.) dhe disenjon 1 punim. - Njeh dhe përdor mjete të shtypit dhe disenjon - (lapsa, flamastera, ngjyra, penel, letër, trekëndësh, gomë, kompjutër,etj). - RNF 2. Përmes përceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse. - Njeh llojet e vijave dhe kupton përdorimin e tyre në vepra arti. - Kupton rëndësinë e vizatimit dhe përdorimin në praktikë (p.sh. filmat e vizatuar, ilustrimet në libra, arkitektura e qytetit etj.).	17. Ilustrim përralle 18. Llojet e vijave në art 19. Rëndësia e vizatimit dhe përdorimi në praktikë 20. Vijat gjeometrike 21. Ngjyrat bazë dhe të përbëra 22. Ngjyrat e ujit ose akuarelet 23. Ngjyrat tempera 24. Krijo kolazh me forma gjeometrike 25. Dalloj ngjyrat në pikturë 26. Forma dhe struktura 27. Unë do të bëhem...	11	Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave; Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar; Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar. Metodat: Ilustrimi; Demonstrimi; Bashkëbisedimi. Teknikat: Stuhimendimesh; Kllaster; Punë e drejtuar; Harta e mendjes; Turi i galerisë; Krijim i lirë.	Vlerësim i vazhdueshëm; Vlerësim i ndërsjellë; Vlerësim individual; Pjesëmarrja në aktivitete; Ushtrime kontrolluese; Listë kontrolli; Portfolio.	- Gjuhë shqipe; - Matematikë; - Edukatë figurative; - Njeriu dhe natyra; - Shoqëria dhe mjedisi; - Shkathtësi për jetë; - Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. - Çështjet ndërkurrikulare: - Të drejtat e fëmijëve; - Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë figurative 2.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare: dhe situatat jetësore	Burimet
	- Tregon së paku 2 shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të vijave të lira ose gjeometrike (orenditë e brendshme dhe në natyrë). - Identifikon ngjyrat bazë dhe përzierjën e ngjyrave të dyta. - Njeh mënyrën e përdorimit të ngjyrave të ujit, akuarel, tempera.						

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Edukatë figurative

Fusha e kurrikulës: Artet **Klasa:** II

Tema mësimore:
- Format dhe modelimi
- Galeri dhe ekspozime
- Profesioni im kur të rritem
- Analiza e punimeve
- Vlerësimi individual
- Projekte dhe shembuj
- Përshkrimi i punimeve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
I.1	Lexon me zë nje tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth gjysmë faqe - me 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para tjerëve.
I.8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo performimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materiale të ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke e laboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast të rrezikut.
II.7	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndosh	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohn në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimin e ndërsjellë tolerancën, solidaritetin , respektin, mirësjelljen) etj.
VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.3	Vizaton, ngjyros, e modelon me laps, me ngjyra, me plastelina, me letër e materiale të tjera në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në temë të caktuar.
2.1	Përmes përceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj. dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.
3.2	Vëren dhe identifikon lloje e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale).
3.3	Emërton disa, së paku katër krijues, interpretues të njohur të gjinive dhe zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale dhe kombëtare.
4.1	Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje dhe mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
4.2	Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. Ai/ajo këndon mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Format modelimi **Profesioni im kur të rritem** **Objekte dhe artefakte** **Projekte dhe shembuj** **Galeri dhe ekspozime** **Analiza e punimeve**	- Dallon format sipas madhësive dhe largësisë (perspektiva). - Përshkruan një tekst të shkurtër për një bust apo vend historik në rrethin tënd. - Me teknikë të lirë kreative realizon 1 punim për profesionin e adhuruar duke komentuar mënyrën e realizimit dhe përdorimin praktik; - Shpjegon mënyrën e ndërlidhjes së lëndëve me punimin e realizuar. - Kupton rëndësinë e komunikimit me masën (p.sh. librat, gazetat, reklama, shenjat, televizioni, celularë, lojërat etj.). - Nxënësi identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri: vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve: vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike. - Emërton disa së paku 4 krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike, globale e kombëtare. - Njeh dhe dallon objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera). - Njeh disa objekte nga arkitektura dhe arti publik në qendrat botërore dhe krahason ato duke treguar rëndësinë dhe vlerën që kanë. - Projekton një ide skicimore për një objekt që pretendon të jet i njohur. - Përdor ornamente qilimash për një projekt ideor. - Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturo-ro-artistike në vend (muzeume, galeri, studio, vende arkeologjike etj.).	28. Komunikoj me të tjerët 29. Objektet e trashëgimisë kulturore 30. Shtatë mrekullitë e botës 31. Skica e planimetrisë 32. Krijoj me motive qilimi 33. Institucionet kulturore 34. Krijuesit shqiptarë 35. Ekspozita e parë 36. Vlerësoj veprat e njohura 37. Punime impresioniste	10	Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave; Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar; Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar. Metodat: Ilustrimi; Demonstrimi; Bashkëbisedimi; Teknikat: Stuhi mendimesh; Kllaster; Punë e drejtuar; Harta e mendjes; Turi i galerisë; Krijim i lirë.	Vlerësim i vazhdueshëm; Vlerësim i ndërsjellë; Vlerësim individual; Pjesëmarrja në aktivitete; Ushtrime kontrolluese; Lista kontrolli; Portfolio.	- Gjuhë amtare; - Matematikë; - Njeriu dhe natyra; - Shkathtësi për jetë; - Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti; - Shoqëria dhe mjedisi. - Ndërlidhja me çështje ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: - Edukimi për qytetari demoktraitke; - Edukimi për paqe; - Arsimi për zhvillim të qëndrue shëm.	Edukatë figurative 2; Burime nga interneti.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Vlerësimi individual **Përshkrimi i punimeve**	- Përshkruan punën e ekspozuar në një galeri qyteti, shkolle apo nga ekspozimi virtualo-elektronik në faqe interneti. - Njeh së paku 2 krijues të njohur të artit figurativ e aplikativ. - RNF 4. Nxënësi/ja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar dhe kritike krijimet artistike individuale dhe të të tjerëve. - Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje mimike, me mjete shprehëse të tjera etj. - Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh. Ai/ajo këndoi mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.). - Bisedon dhe analizon krijimet e realizuara në klasë dhe të ngjashme (së paku 2 punime); - Përshkruan gojarisht punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë. - Përjeton në mënyrë individuale punimet nga veprat e njohura dhe bën një vlerësim estetik sipas përjetimit (2 punime). - Përshkruan 2 punime më ndikuese me shkrim (së paku me nga 3 fjali).						

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vija dhe vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh llojet e vijave dhe kupton përdorimin e tyre në vepra arti;
Përdor lloje te ndryshme të vijave për të krijuar figura dhe objekte.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, II.4, III.1, III.2, III.4.


Krijoj me vija

Me vijë nisem nga një pikë dhe vazhdoj në një drejtim të caktuar.

Me lloje të ndryshme të vijave, mund të krijoj figura e forma.

Mund të krijoj dhe objekte.

Me vija shkruaj dhe formoj shkronja, fjalë e fjali.

Rr

Pra, vijat, format dhe ngjyrat janë të domosdoshme për të realizuar një pikturë.

Vijat mund të jenë të drejta, të lakuara, spirale, zigzage, të trasha, të holla etj.

Vija e drejtë
Vija e lakuar
Vija e trashë
Vija e ndërprerë
Vija e mbyllur
Vija zigzage

Vijat i krijoj me laps, pastel, karbon, flamaster, penel etj.

6

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijoj me vija

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton lloje të ndryshme të vijave;
- Bën dallimin midis vijave të drejta ndaj vijave të lakuara;
- Vizaton llojet e vijave me madhësi të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: ilustrimet me vija, figurat gjeometrike, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Matematikë, Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutim paraprak
Paraqiten disa ilustrime me vija të drejta, të lakuara, të ndërprera, dhe disa ilustirme me forma gjeometrike dhe shkronja. (Mund të përdoren edhe fotot nga libri.)

Parashtrohen pyetjet:
Çfarë vija po shihni? (Të drejta, të lakuara etj.).
Si janë vizatuar katrori, trekëndëshi, rrethi? (Me vija të drejta dhe të lakuara, me ngjyra etj.).
Po shkronja "A" me çfarë vija është vizatuar? (Me vija të drejta).
Po shkronja "C" me çfarë vija është vizatuar? (Me vija të lakuara).



Hapi 2: Nxënësit dallojnë vijat e drejta, të lakuara dhe të ndërprera në tekst.
Bashkëbisedojnë rreth llojeve të vijave që gjenden në tekst.

Hapi 3: Parashtrohen pyetjet:
Me cilat mjete mund të vizatojmë vija të holla? Po vija të trasha?
Nxënësit japin përgjigje duke i shikuar mjetet e vizatimit të vijave sipas trashësisë së vijave në libër.

Hapi 4: Nxënësit punojnë sipas udhëzimeve në libër:
1. Lidh llojet e vijave.
2. Vazhdo vizatimin sipas modelit.
3. Bashko pikat dhe krijo figurën.

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet që të krijojnë punimin e dëshiruar, duke përdorur vija të ndryshme.
Udhëzohen që t'i përdorin lapsat për vizatim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për informatat kthyese me gojë gjatë përgjigjeve që i japin për llojet e vijave si dhe gjatë diskutimeve për mjetet e vizatimit të llojeve të ndryshme të vijave etj.
Vlerësohen për vizatimet e vijave me shkrim me shenja motivuese (fytyra me emocione).

Detyrë:
Të vizatojnë një figurë sipas imagjinatës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Dallon vijat në natyrë dhe vizaton vizatime me vija të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kudo në natyrë ka vija

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton rreth pamjeve në natyrë;
- Dallon formën e figurave në natyrë;
- Vizaton figura me vija të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me videoprojektor paraqiten fotografi të ndryshme të natyrës. Nxiten nxënësit të flasin rreth natyrës, ndryshimeve gjatë stinëve të ndryshme në natyrë. Parashtrohen disa pyetje, si:
- A keni vizatuar ndonjëherë natyrën?
- Keni provuar ndonjëherë të vizatoni ndonjë kërmill, gjethe, pemë?
- Si keni vepruar?

U tregohet nxënësve që kudo në natyrë ka viza. Ata do të punojnë duke i vëzhguar këto vija e gjëra të ndryshme në natyrë.



Fletë pune

Me vija vizatoj natyrën

1. Vizato lulen duke bashkuar pikat.

2. Bashko pikat dhe formo figurën.

Cilat vija përdore?

3. Dallo dhe vizato vijat që janë përdor në vizatim.

4. Vizato natyrën, duke përdorur vija të ndryshme.

9

Hapi 2: Nxënësve u tregohet se me anë të vijave mund të vizatohen figura të ndryshme në natyrë, pastaj në tabelë vizatohen disa lloje të vijave si: vija të drejta, të pjerrëta, të lakuara, të trasha, të holla, zigzage, të hapura, të mbyllura etj.

Hapi 3: Diskutohet për figurat e paraqitura në libër.
Bashkohen pikat dhe formohen figurat, me lloje të ndryshme të vijave.
Tregohen llojet e vijave të përdorura në figurat e dhëna.

Hapi 4: Nxënësit përpiqen ta vizatojnë natyrën.
Pyeten ata: Për ta vizatuar natyrën, a ju shërbeu vija e mbyllur?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e llojeve të vijave në natyrë dhe për përdorimin e tyre në figura të ndryshme.

Detyrë:
Të provojnë të vizatojnë vija të ndryshme në dëborë, ose në rërë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon hapësirat e brendshme dhe vizaton së paku 1 vizatim me hapësirë të tillë (klasë-shtëpi-forma gjeometrike) etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.1, IV.5.


Një botë plot me forma e figura

Format i gjej kudo në natyrë; mjafton t'u kushtoj vëmendje. Shiko figurat.

Pema është një rreth dhe një drejtkëndësh.

Shtëpia është një trekëndësh dhe një katror.

Format i dalloj edhe te figurat gjeometrike: *katrori, rrethi, trekëndëshi, drejtkëndëshi* etj.

10

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Një botë plot me forma e figura

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen objekte me forma gjeometrike në klasë;
- Analizon format e natyrës duke ua gjetur formën gjeometrike;
- Vizaton forma gjeomterike sipas udhëzimeve në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjyrat, lapsi, goma, gjësendet e klasës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Jeta dhe puna, Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet:
Çfarë forma gjeometrike kemi në klasën tonë?
Çfarë forme gjeometrike ka tabela? (Drejtkëndësh);
Çfarë forme ka banka? (Drejtkëndësh);
Çfarë forme ka topi? (Rrethore);
Çfarë forme ka dera? (Drejtkëndësh);
Çfarë forme kanë dritaret? (Katrore ose drejtkëndësh);
Çfarë forme ka kutia që lini lapsat? (Cilindër ose katrore).
Nxënësit gjejnë me ndihmën e mësueses gjësendet me forma të ndryshme gjeometrike në klasë.

Fletë pune

Me vija krijoj figura e objekte

1. Bashko vijat dhe ngjyros figurën.

2. Vizato dhe ngjyros këto tri figura sipas vijave të ndërprera dhe shkruaj vijat e format që dallove:

Vijat:

Format:

3. Vizato klasën tënde, duke përdorur vija dhe forma të ndryshme.

11

Hapi 2: Diskutohet për dy ilustrimet në tekst.
Pema ngjan me topin dhe drejtkëndëshin.
Shtëpia ngjan me disa figura të ndryshme, si: kulmi me trekëndëshin, dritaret me katrorin, dera me drejtkëndëshin.

Hapi 3: Nxënësit vizatojnë katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin, rrethin.

Hapi 4: Nxënësit ndjekin udhëzimet në libër:

1. Bashko vijat dhe ngjyros figurën.
2. Vizato dhe ngjyros këto dy figura sipas vijave të ndërprera dhe shkruaj vijat e format që dallove.
3. Shkruaj vijat dhe format që ke përdorur.

Hapi 5: Nxënësit tregojnë vijat dhe format që kanë përdorur në punimet e tyre.
Diskutojnë për mënyrën se si e kanë punuar atë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e gjësendeve me forma gjeometrike, për saktësinë në vizatimin dhe ngjyrosjen e figurave gjeometrike, për plotësimin e detyra në tekst sipas kërkesave.

Detyrë:
Ta vizatojnë klasën duke përdorur vija dhe forma të ndryshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor mjetet e vizatimit (lapsi, lapsa me ngjyrë, pastele).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; III.1,2,3.

Mjetet e vizatimit

LAPSI

Lapsin e përdori për të shkruar dhe për të vizatuar mbi një sipërfaqe në letër. Zakonisht e përdor lapsin prej grafiti, i cili është i veshur me dru dhe mund të ketë formë gjashtëkëndore, trekëndore, cilindrike etj.

Lapsat janë të butë **B** dhe të fortë **H**, por më shumë e përdor të mesmin **HB**.

PASTELET

Për ngjyrosje shpesh përdor pastelet, sepse kanë ngjyra të ndryshme dhe janë të thjeshta për t'u përdorur.

Me pastele bëj vijat e rregullta, mbushjen e formave, përzierjen e ngjyrave etj.

12

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet e vizatimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njeh mjetet e vizatimit;
- Përdor mjete të ndryshme për vizatim;
- Diskuton rreth mjeteve të punës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, pastelë dhjami, fletë vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraprakisht përgatiten fotografi të ndryshme të mjeteve të vizatimit. Figurat ngjiten në tabelë, pastaj parashtrohen disa pyetje:

- Çfarë po shihni këtu?
- Përse na nevojiten këto mjete?
- Në cilat lëndë i përdorim ato?
- Cilat janë mjetet e vizatimit?
- Prej cilave materiale përgatiten?



LAPSAT ME NGJYRA

Përdor shumë lloje lapsash me ngjyra, sepse përzierja e tyre është e lehtë. Vendos shtresa mbi njëra-tjetrën për të krijuar ngjyra të reja.

FLAMASTERAT

Flamasterat janë si një stilolaps me bojë të lëngshme dhe majë të butë. Mund të jenë të hollë ose të trashë.

A ju pëlqejnë juve t'i përdorni?

KUJDES: kur të përfundoni ngjyrosjen, mbyllini me kapakë, sepse mund të thahen.

13

Hapi 2: Nxënësve u shpjegohet që lapsi është shufër e hollë grafiti ose ndonjë lëndë tjetër me ngjyrë, e veshur me një mbulesë të drunjtë, që përdoret për të shkruar a për të vizatuar zakonisht në fletë letre.

Lapsi më i zakonshëm është dru në formë gjashtëkëndore, trekëndore, cilindrike etj.

Lapsat janë të butë B dhe të fortë H, por më i përdoruri është HB i mesmi.

Hapi 3: Më pas nxënësit udhëzohen që t'i hapin librat dhe të punojnë sipas udhëzimeve të dhëna.

Hapi 4: Nxënësit në fletët e vizatimit do të provojnë të vizatojnë me laps të zi, p.sh.: një lule.
Me pastele ngjyrosin petalet e lules, gjethet dhe bishtin. Kështu mund të vazhdohet edhe me vizatime të tjera, si: topin, lodrat, çantën etj.
Për ngjyrosje përdoren lapsa druri, pastela etj. Përdorimi i akuarelit demonstrohet nga mësuesi/ja në fletën e ngjitur në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njohjen dhe përdorimin e saktë të mjeteve të punës.

Detyrë:
Duke përdorur mjete të ndryshme të vizatimit, të vizatojnë dhe të ngjyrosin sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Vizaton vizatime me vija të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; III.1,2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.



Fletë pune Piktura magjike me vija e mjete të ndryshme

Provo edhe ti.

Ndiq hapat:

Hapi 1: Në një fletë të bardhë kartoni, të madhësisë A4, ngjyros me pastele gjithë sipërfaqen.

Hapi 2: Merr tempera të zinj dhe ngjyros sërish gjithë sipërfaqen që ke ngjyrosur me pastele.

Hapi 3: Pasi të jetë tharë, merr një shkop me majë (p.sh.: një rrëmojëse) dhe gërvishte me të, në tërë sipërfaqen; kësh krijosh një pikturë me ngjyra të larmishme.

Të këshilloj: përpara se ta gërvishtësh ngjyrën, duhet ta skicosh lehtë me laps vizatimin që do ta krijosh. Lapsi i plumbit duket shumë mirë në sipërfaqen e zezë.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Piktura magjike me vija e mjete të ndryshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon mjetet e vizatimit;
- Vizaton me mjete të ndryshme të vizatimit;
- Diskuton për punën e bërë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, pastelë dhjami, tempera, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet një bisedë e shkurtër me nxënësit rreth llojeve të vizatimeve që parapëlqejnë më shumë. Parashtrohen pyetjet:
- Keni provuar ndonjëherë të vizatoni mbi sipërfaqe të ngjyrosur?
- Keni provuar të bëni vizatime magjike me shkop?
- Dini çfarë lloje të ngjyrave na nevojiten?

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit që në një fletë të bardhë kartoni, me madhësi A4, të ngjyrosin me pastelë dhjami gjithë sipërfaqen me ngjyra të ndryshme.
Nxënësit do të marrin tempera të zinj dhe do të lyejnë të gjithë sipërfaqen e ngjyrosur me pastele.

Pasi të jetë tharë, marrin një shkop me majë dhe fillojnë të kruajnë gjithë sipërfaqen.

Fletë pune Vizatimi im

1. Krijo vizatimin tënd, duke përdorur llojet e vijave dhe mjetet e vizatimit që ke mësuar.

16

Kështu, ata kanë krijuar një pikturë me ngjyra të larmishme.

Përpara se ta kruajnë ngjyrën, nxënësit duhet ta bëjnë lehtë me laps vizatimin që do të krijojnë.

Lapsi i plumbit duket shumë mirë në sipërfaqen e zezë.

Hapi 3: Nxënësit i vendosin punimet e tyre në këndin e klasës. Diskutohet për secilin punim dhe jepen mendime për punën e bërë. Bëhet zgjedhja e punimit më të bukur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e mjeteve të ndryshme të vizatimit dhe përdorimin e tyre gjatë realizimit të tij.

Detyrë:
Të krijojnë vizatim duke përdorur llojet e vijave dhe mjetet e vizatimit që kanë mësuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ngjyra

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta dhe efektet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.7, II.1, II.8, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.1, 4.2.


Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta

Ju mund t`i dalloni shumë lehtë ngjyrat e ngrohta nga ato të ftohtat; ngjyrat e ngrohta shkojnë kah e verdha, ndërsa të ftohtat kah e kaltra. Në verë dominojnë ngjyrat e ngrohta, ndërsa në dimër ngjyrat e ftohta.

Ngjyrat e ngroh

Ngjyrat e ftoh

A e dini se: ngjyrat e ngrohta - e kuqja, e portokallta, e verdha, si dhe kombinimet e tyre na bëjnë më të gëzueshëm.

Kurse ngjyrat e ftohta: e gjelbra, e kaltra, vjollca na relaksojnë dhe na qetësojnë.

18

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon llojet e ngjyrave në mjedis dhe në natyrë;
- Diskuton për ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta;
- Realizon dy figura me ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjyrat e drurit, lapsi, goma, libri, vizorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Matematikë, Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Bashkëbisedohet me nxënësit për peizazhet që i shohin në tekst, për natyrën dhe ngjyrat që janë përdorur.
Parashtrohen pyetje për ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta, si:
Cilat janë ngjyrat e ngrohta?
Cilat janë ngjyrat e ftohta?
Ngjyrat e ngrohta shkojnë nga e verdha kurse ngjyrat e ftohta shkojnë nga e kaltërta.
Po ashtu në stinën e verës dominojnë ngjyrat e ngrohta, kurse në stinën e dimrit mbizotërojnë ngjyrat e ftohta.
Po ashtu ngjyrat e ngrohta mund të ndikojnë edhe në disponimin e njerëzve duke i bërë ata më të gëzueshëm, kurse ngjyrat e ftohta shkaktojnë relaksim dhe qetësi.



Fletë pune

Ngjyros me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta

1. Ngjyros figurën me ngjyra të ngrohta.

Shkruaj ngjyrat që përdore: _____

2. Ngjyros figurën me ngjyra të ftohta.

Shkruaj ngjyrat që përdore: _____

3. Vendos ✓ për ngjyrën që të pëlqeu. Pse?

◯ e verdhë ◯ e portokalltë ◯ e kuqe

◯ vjollcë ◯ e kaltër ◯ e gjelbër

19

Hapi 2: Lexohet teksti për llojet e ngjyrave nga mësimdhënësi/ja. Ngjyrat e ngrohta shumë lehtë i dallojmë nga ato të ftohtat, nga ngjyrat e ngrohta shkojnë nga e verdha, ndërsa ngjyrat e ftohta nga e kaltra.
Diskutohet për peizazhet në tekst.
Parashtrohen pyetjet:
Cila ngjyrë ju pëlqen më tepër? Pse ju pëlqen?

Hapi 3: Nxënësit shkruajnë emrin e tyre dhe i ngjyrosin shkronjat me ngjyra të drurit. Ngjyrosja bëhet sipas ngjyrave që ata pëlqejnë.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit të realizojnë dy figura: njërën me ngjyra të ngrohta dhe tjetrën me ngjyra të ftohta, sipas udhëzimeve në tekst.

Hapi 5: Diskutojnë për punimet e njëri-tjetrit dhe për ngjyrat e përdorura;
për llojet e tyre, si dhe për ngjyrat që u pëlqejnë.
Nxënësit shkruajnë për ngjyrat e përdorura.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që japin, për llojet e ngjyrave, për realizimin e dy figurave të bëra dhe ngjyrat që i kanë përdorur.

Detyrë:
Ta vizatojnë shkollën dhe ta ngjyrosin atë me ngjyra të drurit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ngjyra

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.1.


Kontrasti i ngjyrave

Kontrast quajmë ndryshimin midis dy elementeve: ngjyrës, forn etj. Në këtë fotografi, kemi kontrastin e ngjyrës së ngrohtë me ftohtën.

Dallimin e ngjyrave e vërej dhe te ky punim.

20

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kontrasti i ngjyrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton rreth temës;
- Dallon ngjyrat kontraste;
- Vizaton dhe ngjyros me ngjyra kontraste.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Njihen nxënësit me temën e mësimit. U shpjegohet kuptimi i fjalës "kontrast" që do të thotë "dallim i madh" ku në këtë rast, dallimi i madh është ndërmjet ngjyrës së bardhë dhe të zezë. Pastaj bisedohet rreth peizazheve të paraqitura në libër, ku është paraqitur kontrasti në mes të dritës dhe errësirës. Lihen nxënësit t'i vëzhgojnë në heshtje pikturat dhe t'i shprehin mendimet e tyre.

Hapi 2: Pyeten nxënësit:
Kur e shikoni këtë pikturë (Nata në qytet), çfarë ju bën më shumë përshtypje? (Hëna, ngjyra e kaltër, ngjyra e bardhë, e zezë etj.)
- Çfarë tregon ngjyra e bardhë? (Hënën).
- Ku është përdorur ngjyra e zezë? (Në errësirën e natës).
- Po qielli? (I kaltër).
- Çfarë teknike ka përdorur piktori? (Pikturë).
- Emërtoni disa lloje vijash që shikoni aty. (Rrethore, e drejtë, e lakuar...).



Fletë pune Ngjyros mjetet e pikturës

1. Ngjyros ditën dhe natën me lapsa me ngjyra.

Shkruaj ngjyrat që përdore: _____

2. Ngjyros figurën duke përdorur kontrastin e ngjyrave me pastel.

Shkruaj ngjyrat që përdore: _____

3. Shih fotografinë e këtij peizazhi të natës dhe, pastaj, vizato edhe ti një të tillë në bllokun tënd të vizatimit. Ngjyrose me ngjyra tempera. Figurat errësoji duke i përzier ngjyrat me pak të zezë. Pasi të jetë tharë piktura me ngjyra të errëta, merre ngjyrën e verdhë dhe ngjyrosi figurat për ndriçim.

4. Fotokopjo foton tënde pa ngjyra, ngjite në libër dhe ngjyrose me flamaster.

21

- Cilat janë ngjyrat e ftohta që ka përdorur piktori?
- Çfarë ju pëlqen më shumë te kjo vepër?

Hapi 3: Pyeten nxënësit nëse kanë dëshirë edhe ata të vizatojnë këtë pikturë me ngjyra konstraste.

Në fletën e bardhë të vizatimit do të ngjyrosin me ngjyrë të kaltër, më pas do të lënë atë që të thahet. Më pas me pastele ngjyroset hëna dhe retë me ngjyrë të bardhë, si dhe theksohen të gjitha hijezimet e duhura si në pikturë. Plotësohen detyrat 1 dhe 2, sipas udhëzimeve të dhëna në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin rreth temës, dallimin dhe përdorimin e ngjyrave kontraste.

Detyrë:
Ta fotokopjojnë foton e tyre pa ngjyrë dhe ta ngjitin në libër duke e ngjyrosur me flamaster.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ngjyra

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor mjetet e ngjyrosjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3;II.4, III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.2.


Pranvera në kopshtin tim

Ngjyros me flamastera.

84

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjyros me flamastera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Merr pjesë aktive në diskutimet për temën;
- Përshkruan ngjyrosjen me flamaster.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat flamastera, fotografi të nxënësve, fletë vizatimi etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpjegohet se drita e diellit i dhuron natyrës ngjyra.Të gjitha ngjyrat takohen bashkë dhe formojnë urën e ylberit. Ylberi ka shtatë ngjyra. Ato janë: vjollcë, e kuqe, e portokalltë, e verdhë, e gjelbër, e kaltër dhe manushaqe.
Shpërndahen fletët a4, ku është e paraqitur figura e ylberit (pa ngjyrë).
Udhëzohen nxënësit që ta ngjyrosin ylberin me flamaster, duke pasur kujdes renditjen e ngjyrave të ylberit.



Hapi 2: Nxënësve u shpjegohet se flamasterat janë një lloj stilolapsi me bojë të lëngshme dhe majë të butë.
Ka dy lloje: të hollë e të trashë. Fëmijëve u pëlqen shumë t'i përdorin.

Këshillohen që kur ta përfundojnë ngjyrosjen, t'i mbyllin flamasterat me kapakë, sepse mund të thahen.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit që të vizatojnë sipas dëshirës dhe të ngjyrosin me flamastera duke i kombinuar ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta.

Hapi 4: Punimet e mbaruara vendosen mbi bankë dhe nxënësit në grupe bëjnë krahasimin, diskutimin për ngjyrosjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, saktësinë e ngjyrosjes me flamaster dhe përshkrimin e punimit të përfunduar.

Detyrë:
Të vizatojnë dhe të ngjyrosin me flamastera, sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 9

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Forma dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Përdor materiale të ndryshme për krijime modelimi tridimensionale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.



Modelimi i figurave gjeometrike dhe forma 3D

Shpeshherë modeloj figura e forma të ndryshme 3-dimensionale.

E di ti se çfarë janë format 3D?

Kur marr një kuti në duar dhe e vështroj nga të gjitha anët: poshtë-lart, para-prapa dhe majtas-djathtas, pra mund ta shoh nga të gjitha anët, atëherë kuptoj se ky objekt është tredimensional ose 3D.

Format 3D i shoh kudo në natyrë, sikurse: katrorin si kuti, trekëndëshin si piramidë, rrethin si top e shumë të tjera.

Katrorin, kur e shoh në formën 3D, e quaj kub.

Trekëndëshin e quaj piramidë.

Ndërsa rrethin e quaj sferë.

Kubi

Piramida

Sfera

24

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modelim i figurave gjeometrike dhe forma 3D

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njeh materialet për modelim të figurave;
- Modelon në mënyrë personale figurat;
- Përshkruan punimin e përfunduar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, kuti kartoni.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u parashtrohen disa pyetje:
- Keni dëgjuar ndonjëherë për vizatimin tridimensional?
- Çfarë është ai?
- Si mund të vizatohet një figurë në formë tridimensionale?

Merret një kuti në duar dhe rrotullohet nga të gjitha anët, duke vështruar para-prapa, poshtë-lart, majtas e djathtas. Kur objekti mund të shikohet nga të gjitha anët, atëherë quhet tridimensional (3D).

Hapi 2: Diskutohet për figurat e paraqitura në libër.
Format 3D janë kudo në natyrë dhe në forma të ndryshme, p.sh., trekëndëshi është si piramida, katrori si kuti, drejtkëndëshi si libër dhe sfera si topi.



Modelimi i figurave gjeometrike dhe forma 3D

Shpeshherë modeloj figura e forma të ndryshme 3-dimensionale.

E di ti se çfarë janë format 3D?

Kur marr një kuti në duar dhe e vështroj nga të gjitha anët: poshtë-lart, para-prapa dhe majtas-djathtas, pra mund ta shoh nga të gjitha anët, atëherë kuptoj se ky objekt është tredimensional ose 3D.

Format 3D i shoh kudo në natyrë, sikurse: katrorin si kuti, trekëndëshin si piramidë, rrethin si top e shumë të tjera.

Katrorin, kur e shoh në formën 3D, e quaj kub.

Trekëndëshin e quaj piramidë.

Ndërsa rrethin e quaj sferë.

Kubi

Piramida

Sfera

24

Kur katrori shikohet në 3D, është kub.
Trekëndëshi në formë 3D quhet piramidë.
Pastaj nxënësit udhëzohen që materialin e sjellë më parë ta lënë mbi bankë dhe t'i dëgjojnë udhëzimet për të modeluar një kamion nga kutia e kartonit.
Si realizohet një makinë me kartonë?

Hapi 3: Merren 2 kuti kartoni të madhësive të ndryshme. Kutia e vogël duhet për kabinën, ndërsa e madhja për rimorkion. Do të prit-en 4 rrathë prej kartoni për rrotat e kamionit. Pasi t'i vizatojnë dhe t'i ngjyrosin kartonët, i ngjitin ata.

Hapi 4: Për disa minuta nxënësit vëzhgojnë punët e njëri-tjetrit. Ata shpjegojnë krijimin e tyre, materialet e përdorura dhe ç'ndjesi u solli kjo punë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njohjen e materialeve për modelimin e figurave, për modelimin e figurës së kamionit dhe përshkrimin e tij.

Detyrë:

_____

_____

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

_____

_____

Mësimi 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Forma dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Përdor materiale të ndryshme, të lehta për krijime modelimi (3 dimensionale).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.3, II.7, II.1, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.

Fletë pune Krijoj figura gjeometrike me plastelinë

Plastelina është një material që zakonisht e përdorim në lojërat dhe krijimet tona.

Provo edhe ti.
Krijo figurën sipas udhëzimeve:

Merr një copë plastelinë dhe vendose midis pëllëmbëve.
Rrotulloje në mes të duarve dhe shtype nga pak; kështu do të formosh një top.

Të këshilloj: punoje sa më shumë me duar që të kesh një sipërfaqe sa më të lëmuar.

Për ta krijuar kubin, pasi ta kesh zbutur mirë plastelinën, shtype nga pak nga të gjitha anët, që të kesh një katror me faqe të barabarta.
Në të njëjtën mënyrë mund ta realizosh edhe piramidën, por shtype më shumë në majë.
Ndërsa cilindri realizohet duke e mbajtur plastelinën në mes të pëllëmbëve dhe duke lëvizur duart para-prapa.

25

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijoj figura gjeometrike me plastelinë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krijon me shkopinj figurat gjeometrike;
- Dallon figurat e modeluara nga forma, madhësia, ngjyra;
- Modelon me plastelinë sipas modelit në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shkopinj, plastelinë, letra me ngjyra, gërshërë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Udhëzohen nxënësit të krijojnë figura gjeometrike me shkopinj të drurit.
Figurat gjeometrike:

katrori

trekëndëshi

drejtkëndëshi

Parashtrohen pyetjet: Çfarë keni modeluar? (Figurat gjeometrike).
A mund të modelojmë edhe me materiale të tjera? (P.sh. me plastelinë).

Fletë pune Krijoj figura gjeometrike me plastelinë

Plastelina është një material që zakonisht e përdorim në lojërat dhe krijimet tona.

Provo edhe ti.
Krijo figurën sipas udhëzimeve:

Merr një copë plastelinë dhe vendose midis pëllëmbëve.
Rrotulloje në mes të duarve dhe shtype nga pak; kështu do të formosh një top.

Të këshilloj: punoje sa më shumë me duar që të kesh një sipërfaqe sa më të lëmuar.

Për ta krijuar kubin, pasi ta kesh zbutur mirë plastelinën, shtype nga pak nga të gjitha anët, që të kesh një katror me faqe të barabarta.
Në të njëjtën mënyrë mund ta realizosh edhe piramidën, por shtype më shumë në majë.
Ndërsa cilindri realizohet duke e mbajtur plastelinën në mes të pëllëmbëve dhe duke lëvizur duart para-prapa.

25

Hapi 2: Plastelina është material që përdoret për modelimin e figurave dhe gjësendeve të ndryshme. Demonstrohet se si punohet me plastelinë.
Merret një plastelinë, e cila vendoset midis pëllëmbëve të duarve; shtypet duke e rrotulluar. Në këtë mënyrë formohet topi.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të modelojnë me plastelinë kubin, piramidën, cilindrin sipas modelit në libër.

Hapi 4: Nxënësit i prezantojnë punimet para klasës.
Komentojnë mënyrën e modelimit të kubit, të cilindrit, të piramidës me plastelinë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen me informata kthyese me gojë për komentimin e figurave gjeometrike të modeluara me shkopinj.
Vlerësohen me informata kthyese me shkrim për trupat gjeometrikë të modeluar me plastelinë.

Detyrë:
Të modelojnë një kafshë me plastelinë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 11

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Forma dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Përdor materiale të ndryshme për krijime modelimi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.



Krijoj figura simetrike

Kur e palos një figurë në mes, do të të dalin dy pjesë të barabarta. Pra, figura do të ketë dy anë saktësisht të barabarta (të njëjta). Këtë figurë e quajmë **simetrike**.

Ti mund të krijosh shumë figura të tilla. Provo.

26

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijoj figura simetrike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Ndan figurat në pjesë simetrike;
- Modelon në mënyrë personale figurat me materialin e tekstilit;
- Diskuton rreth temës së kolazhit me tekstil.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, litar, lecka, bojëra vaji etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletët a4 , ku janë të paraqitura figura simetrike.
Udhëzohen që së pari t'i palosin në mes dhe të tregojnë se çka po vërejnë te figurat.
(Ndahet figura në dy pjesë të barabarta).
Atëherë thuhet se figurat janë ndarë në dy pjesë simetrike.
Udhëzohen nxënësit që duke e formuar simetrinë e figurave, t'i plotësojnë detyrat e dhëna në libër.
Pyeten ata:
- Ju kujtohet në matematikë? (po)
- Po tani, më thoni, keni dëgjuar për kolazhin?
- Çfarë është ai?
- Si mund të realizohet një kolazh?
- Me cilat materiale mund ta realizojmë kolazhin?



Fletë pune

Krijo figura simetrike

1. Vendos pasqyrën te vija e zezë e figurës dhe shkruaj çfarë shikon.

2. Atë që shikove në pasqyrë, vizatoje në anën e djathtë të vijës së zezë.

3. Vizato drejtëzat e simetrisë.

4. Krijo një figurë simetrike prej letre. Prite dhe ngjite këtu.

27

Hapi 2: Nxënësve u shpjegohet se kolazhi realizohet duke bashkuar, ngjitur e mbivendosur imazhe dhe materiale të ndryshme në një sipërfaqe.
Në kolazh mund të përdorim materiale, si: litar, lecka, bojëra vaji etj.

Më pas udhëzohen që t'i mbyllin sytë dhe të mendojnë se çfarë duan të modelojnë me materialet e tekstilit , të cilat i kanë sjellë nga shtëpitë e tyre.

Ata me materialet e ndryshme të tekstilit mund të modelojnë figura të ndryshme si: kukullat e tyre, lodrat e ndryshme më të preferuara, librat etj.

Hapi 3: Vendosen në këndin e klasës punët e përfunduara dhe nxënësit vëzhgojnë të lirë. Ata shpjegojnë punët e tyre, materialet e përdorura, ngjyrat e tekstilit të përdorur etj.

Hapi 4: Diskutohet rreth figurave në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në ndarjen e figurave në mënyrë simetrike dhe modelimin e kolazhit me tekstil.

Detyrë:
Të marrin copa të tekstilit me ngjyra dhe të krijojnë edhe ata nga një pikturë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Forma dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krijonë një kështjellë me plastelinë sipas një tregimi popullor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.4, II.3, II.4, II.7, III.1, III.4, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.

Modeloj kështjellën me plastelinë

Krijova kështjellën e Argjiros, sipas legjendës nga vjen edhe emri i qytetit të Gjirokastrës.

Argjiroja ishte princesha e qytetit asokohe dhe ishte e rrethuar nga ushtria turke e luftonte me ushtarët e saj për ta mbrojtur atdheun. Njëri nga rojat e saj e tradhtoi, duke ua treguar turqve tunelin e fshehtë. Për të mos u dorëzuar, ajo u hodh nga kulla më e lartë e kështjellës, së bashku me foshnjën e saj. Mirëpo, sipas legjendës, foshnja mbijetoi. Më vonë, emri i princeshës iu vu qytetit të Gjirokastrës.

Provo edhe ti: me format gjeometrike që ke mësuar, krijo një kështjellë me plastelinë.

29

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modeloj kështjellën me plastelinë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krijon me plastelinë shkronjat e shtypit;
- Dallon figurat e modeluara nga forma, madhësia, ngjyra;
- Modelon me plastelinë kështjellën sipas modelit në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkopinj, plastelinë, letra me ngjyra, gërshërë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Krijim i lirë
Udhëzohen nxënësit të krijojnë me plastelinë shkronjat e shtypit.

Ata ndahen në grupe dhe punojnë nga një shkronjë.

A, T, I, H, Y, N

Hapi 2: Lexohet teksti nga libri për historikun e princeshës Argjiro.
Argjiroja ishte princesha e qytetit asokohe dhe ishte e rrethuar nga ushtria turke e luftonte me ushtarët e saj për ta mbrojtur atdheun. Njëri nga rojet e saj e tradhtoi, duke ua treguar turqve tunelin e fshehtë. Për të mos u dorëzuar, ajo u hodh nga kulla më e lartë e kështjellës, së bashku me foshnjën e saj. Mirëpo, si-



Fletë pune Krijimi im

1. Krijo punimin tënd, duke përdorur materiale sipas dëshirës. Ngjiti ato.

Përshkruaj shkurtimisht punimin që krijove, duke treguar se cilat materiale dhe mjete përdore.

30

pas legjendës, foshnja mbijetoi. Më vonë, emri i princeshës iu vu qytetit të Gjirokastrës.

Diskutohet për figurën e modeluar në libër.

Figurat mund të krijohen me materiale të ndryshme:
me letër, me plastelinë, shkopinj etj.

Udhëzohen nxënësit të modelojnë me plastelinë kështjellën e Argjiros sipas modelit në libër.

Hapi 3: Nxënësit prezantojnë punimet para klasës.
Komentojnë mënyrën e modelimit të kështjellës me plastelinë.
Diskutojnë për format, ngjyrat që i kanë modeluar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen me informata kthyese me gojë, për komentimin e figurave të modeluara me shkopinj.
Vlerësohen me informata kthyese me shkrim për kështjellën e modeluar me plastelinë.

Detyrë:
Të plotësojnë në faqe 30.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 13

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Gjurmët dhe shenjat

Rezultatet e të nxënit të temës: Kupton artin e shtypit të thjeshtë p.sh. vula, shtypja me kompjuter, libri, posteri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, II.1, II.7, III.1, III.3, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.


Vula ose stampimi

Me vulë mund të lë shenjë mbi letër ose kudo që stampoj.

Atë mund ta krijoj me gjëra të ndryshme, si me: sapun, plastelinë, dru, gomë, tapa shisheje, me fruta dhe perime, si: patate, limon, mollë, dardhë etj.

Provo edhe ti.
Krijo vula me fruta të ndryshme.

32

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vula ose stampimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shtyp imazhe të duarve me ngjyra të ndryshme në letër;
- Dallon vulën dhe mjetet e stampimit;
- Shtyp imazhe grafike sipas udhëzimeve në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, gjethja, letra, ngjyra, patate, mollë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhët dhe komunikimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten para nxënësve disa pjata plastike të mbushura me ngjyra tempera:
pjata 1 - ngjyra e kuqe;
pjata 2 - ngjyra e kaltër;
pjata 3 - ngjyra e verdhë;
pjata 4 - ngjyra e gjelbër.
Nxënësit vendosin duart në atë ngjyrë që u pëlqen, pastaj shtypin me duar mbi disa hamera që i vendos mësuesja në klasë varësisht nga numri i nxënësve që ka në klasë.
Pyeten nxënësit:
Çfarë keni bërë?
A i keni shtypur duart mirë?
Si ju dolën punimet?
Po ju pëlqejnë?

Vula ose stampimi

le vulë mund të lë shenjë mbi letër ose kudo që stampoj.

të mund ta krijoj me gjëra të ndryshme, si me: sapun, astelinë, dru, gomë, tapa shisheje, me fruta dhe perime, : patate, limon, mollë, dardhë etj.

Provo edhe ti.
Krijo vula me fruta të ndryshme.

32

Hapi 2: Shpjegohet termi "vulë". Vula është një formë që lë shenjë mbi letër ose kudo që e stampojmë (shtypim).
Pyeten nxënësit me çka e krijuam vulën më herët.
(Me duart tona duke i ngjyrosur ato dhe duke i shtypur pastaj në letër).

Hapi 3: Nxënësve u shpjegohet për mjetet me të cilat realizohet vula ose stampimi.
Ato mjete mund të jenë: sapun, plastelinë, dru, gomë, tapa shisheje si dhe pemë dhe perime, si: patate, mollë, dardhë, limon etj.

Hapi 4: Nxënësve u demonstrohet mënyra e stampimit me gjethe dhe me fruta.
Pastaj ata udhëzohen të ngjyrosin disa gjethe dhe t'i shtypin në letër.
Motivohen që të kenë kujdes gjatë ngjyrosjes së gjetheve dhe frutave, si dhe të mos e të dëmtojnë letrën ose gjethen gjatë shtypjes.
U demonstrohen edhe shtypjet me mollë, patate në letër. Udhëzohen të krijojnë vula me fruta të ndryshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në stampimet e duarve, për ngjyrosjen e gjetheve dhe stampimin e tyre në letër.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 14

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Gjurmët dhe shenjat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor mjetet e modelimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.5, I.8; II,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.1.



Si të krijoj një libër?

Provo edhe ti të krijosh një libër sipas hapave të mëposhtëm. Pastaj, mund të shkruash poezi, të vizatosh etj. Për të mësuar shpejt e thjesht se si të bësh një libër, do të përdorësh një letër A4 ose A3.

1. Palose letrën në mes dhe hape përsëri.
2. Palose përsëri letrën, por nga ana tjetër dhe hape përsëri.
3. Palose gjysmën e poshtme të fletës deri në mes dhe hape përsëri.
4. Palose gjysmën e pjesës së sipërme dhe hape përsëri.
5. Pasi ta palosësh, prite me gërshërë.
6. Prite në mes.
7. Palose.
8. Libri është gati.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si të krijoj një libër?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton rreth temës me ndihmën e fjalëve kyçe;
- Modelon me mjetet e modelimit;
- Vizaton dhe ngjyros librin e modeluar;
- Shkruan një tregim në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, fletë a4 dhe a3 etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Caktohen katër terma që përdoren shpesh brenda orës fjalë kyçe të mësimit. Nga këto fjalë nxënësit (për 5 minuta) thurin një ngjarje, apo fjali me kuptim ku përfshihen këta katër terma.

Shembull: Fjalët kyçe mund të jenë: fleta, kopertina, ilustrime, ngjarje, tregime etj. Nga lidhja e këtyre fjalëve nxënësit do të formojnë nga një fjali me kuptim dhe do të arrijnë te tema.
Çfarë do të modelojmë sot? (Një libër).



Si të krijoj një libër?

Provo edhe ti të krijosh një libër sipas hapave të mëposhtëm. Pastaj, mund të shkruash poezi, të vizatosh etj. Për të mësuar shpejt e thjesht se si të bësh një libër, do të përdorësh një letër A4 ose A3.

1. Palose letrën në mes dhe hape përsëri.
2. Palose përsëri letrën, por nga ana tjetër dhe hape përsëri.
3. Palose gjysmën e poshtme të fletës deri në mes dhe hape përsëri.
4. Palose gjysmën e pjesës së sipërme dhe hape përsëri.
5. Pasi ta palosësh, prite me gërshërë.
6. Prite në mes.
7. Palose.
8. Libri është gati.

Hapi 2: Nxënësve u tregohet se si me një fletë a4 ose a3 mund të modelohet një libër.

Tregohen udhëzimet e njëpas-njëshme të paraqitura me fotografi dhe sqarime në libër.

Kështu nxënësit do të kenë shumë më lehtë të modelojnë librin.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen që në librin e modeluar të shkruajnë nga një tregim. Në secilën faqe të shkruajnë një pjesë të tregimit dhe poshtë pjesës të vizatojnë atë për të cilën bëhet fjalë në atë pjesë. Në fund, tregimit i vendoset një titull, shkruhet në kopertinën e librit, si dhe ngjyroset kopertina sipas dëshirës.

Hapi 4: Diskutohet rreth librave të modeluar dhe lexohen disa tregime nga librat.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin aktiv rreth temës, për modelimin e saktë dhe përfundimin e punimit të librit.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Gjurmët dhe shenjat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Disenjon një poster me temën "Vendi i bukur".

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.1, II.3, II.7, III.1, III.2, III.3, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.2, 4.2.

Si të krijoj një poster?

Posteri është një letër e madhe që përmban tekst dhe figura. Shtypet dhe zakonisht ngjitet në mure ose në sipërfaqe të sheshta. Shpesh përdoret si mjet reklamimi, për të dhënë një mesazh etj. Posteri mund të përdoret edhe për dekorim.

Edhe ti mund të krijosh posterin tënd, përmes kompjuterit. Kërko ndihmën e mësuesit/es ose të prindërve për ta krijuar posterin tënd.

Detyrë:
Krijoni një poster në klasë, me titullin "23 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Librit".

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si të krijoj një poster?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përzgjedh një punim nga një lëndë e caktuar;
- Diskuton për posterat e ekspozuar;
- Punon një poster me tekst dhe figura të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Punimet e nxënësve, posteri, lapsi, libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutim paraprak

Nxënësit përzgjedhin nga një punim për ekspozitë.
Punimet (postera nga lëndë të ndryshme) e tyre vendosen në një kënd të klasës.
Diskutohen punimet e përzgjedhura nga nxënësit.
Shpjegohet si janë punuar posterat nga lëndë të ndryshme me ndihmën e nxënësve.

Hapi 2: Punë e drejtuar me tekst.
Lexohet teksti në heshtje.
Pas leximit parashtrohen pyetjet:
Çka është posteri? (Letër e madhe me tekst dhe foto).

Fletë pune Vizato një poster

1. Vizato një poster sipas dëshirës.

35

Si punohet? (Me vizatime, shtypet).
Ku vendoset? (Në mure ose në shesh).
Për çka shërben posteri? (Për reklamë, për dekorim).

Hapi 3: Diskutohen posterat në tekst "Vendi im", "Shrek", "Superman".

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit që të krijojnë një poster me temën "23 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Librit".
Vendosin posterat në murin e klasës.
Shpjegojnë si e kanë punuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet që i japin me informata kthyese me gojë. Vlerësohen për punimet e përzgjedhura me shenja motivuese (yje, fytyra të buzëqeshura) etj.

Detyrë:
Të plotësojnë në faqe 35.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 16

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Gjurmët dhe shenjat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor mjetet e disenjimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

Mjetet e shtypit dhe të disenjimit

Këto që po i shihni më poshtë janë disa nga mjetet që përdoren për disenjim: p.sh. për disenjimin e librave të ndryshëm, siç është edhe ky libër shkollor që ti ke në dorë. Po ashtu, për hapësira të ndryshme, për të projektuar objekte, për të ilustruar personazhe të filmave vizatimorë, për reklama etj.

Lapsat
Letrat
Kompjuteri
Ngjyrat
Vizoret
Gomat

36

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet e shtypit dhe të disenjimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton rreth disenjimit;
- Dallon llojet e disenjit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, videoprojektori, lapsi, ngjyrat etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me videoprojektor paraqiten fotografi të ndryshme, ku nxënësit njihen me lloje të ndryshme të disenjit.
Tregohen shembuj dhe pamje si modele të kolltukëve, të karrigeve, enë kuzhine, forma të telefonave etj. Disenji është arti i projektimit të objekteve të përdorimit të përditshëm si nga ana funksionale, ashtu edhe nga ana estetike.

Hapi 2: Përmenden disa lloje të disenjimit, si: disenji grafik i cili bazohet në ilustrimin e kompozimeve, të logove, të imazheve etj.
Disenji i modës, ku shpaloset krijimtaria në mënyrën më të mirë, për të ekspozuar në mënyrë origjinale tendencat e modës dhe gjithçka që lidhet me prodhimin e këpucëve, të bizhuterive dhe të dhe aksesorëve që kërkohen nga popullata në përgjithësi.



Fletë pune

1. Vazhdo vizatimin e figurave dhe ngjyros.

2. Vizato dhe ngjyros një shenjë rrugore që ke parë në rrugë.

Shkruaj mjetet që përdore:

37

Disenji industrial, i cili i dedikohet disenjit të automobilave, mobiljeve, produkteve, lodrave, makinerive dhe pajisjeve.
U shtrohet një pyetje pyetje rreth disenjimit: A keni vizatuar ndonjëherë veshje për kukulla?

Hapi 3: Nxënësve u shpjegohet se cilat janë mjetet e nevojshme për disenjimin e figurave të ndryshme në vizatim, p.sh.: lapsi, letra, kompjuteri, ngjyrat, vizorja, goma etj.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen që të vazhdojnë vizatimin dhe ngjyrosjen e figurave të dhëna në libër.
Më pas në dyshe diskutojnë për punën e bërë në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin aktiv rreth temës dhe dallimin e llojeve të disenjimit.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 17

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Gjurmët dhe shenjat

Rezultatet e të nxënit të temës: Realizon një ilustrim sipas një shkrimi që ka lexuar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, I.4, I.5, I.6, II.7, III.3, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 4.1.



Ilustrim përralle

Kur lexoj libra me përralla, tregime e poezi, shoh edhe figura që lidhen me tekstin.

Këto figura janë ilustrime.

Ilustruesi i vizaton me kujdes personazhet, skenat etj.

Po ti, ke provuar të ilustrosh ndonjë përrallë që ke lexuar?

38

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ilustrim përralle

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për përrallat duke u përgjigjur pyejeve të mësueses;
- Ritregon përrallën e dëgjuar (shikuar) nga projektori;
- Vizaton dhe ngjyros bukur personazhin e preferuar;
- Realizon një ilustrim sipas përrallës së lexuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, letër vizatimi, gërshërët, ngjitësi i letrës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Përmes projektorit shfaqet para nxënësve përralla "Lepuri dhe breshka", e cila gjendet në linkun: https://youtu.be/5ElAnqhuKik.

Parashtrohen pyetjet:
1. A ju pëlqejnë përrallat? Çfarë mësoni prej tyre?
2. Cilat janë personazhet e saj?
3. Në cilën lëndë keni mësuar të lexoni përralla?
4. Cili personazh ju pëlqen më shumë? Pse?
5. Cilat përralla dini të tregoni ju?

Fletë pune Ilustroj përrallën

1. Ilustro përrallën sipas fjalive.

"Sot në pyll një shkollë u hap... Urdhëroni, të mësoni, kokën tuaj t'pasuroni!"

Klasa "A" ka abetare, fillon shkronjat nga e para, me mësues një Ari, shtatgjatosh edhe të zi:

39

Hapi 2: Shpjegohet termi "Ilustrim"
Ilustrimi është figura që realizon piktori i një përralle, vjershe, historie d.m.th. përmbledhje e disa faqeve të librit në një pikturë me ngjarjet e personazheve.
Ilustrimi realizohet sipas imagjinatës së secilit, teksti mund të jetë i njëjtë, por piktori ndryshon, po kështu edhe ilustrimi është ndryshe.

Hapi 3: Diskutohet për ilustrimin në libër.
Ilustruesi i vizaton me kujdes personazhet, skenat etj. Pyeten nxënësit nëse kanë provuar ta ilustrojnë përrallën që kanë lexuar.

Ata do ta ilustrojnë përrallën sipas fjalive të dhëna në libër.

Hapi 4: Ngjyroset ilustrimi i përrallës duke e shikuar modelin e ngjyrosur në faqen e parë të mësimit. Kështu do të vazhdohet edhe me pjesët e tjera të ilustrimit.

Hapi 5: Ritregohet ngjarja e ilustruar sipas ilustrimeve në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e personazhit të preferuar të përrallave, për vizatimin dhe ngjyrosjen me kujdes, saktësinë në ngjyrosje si dhe për prerjen dhe ngjitjen e saktë të figurës së dhënë në libër.

Detyrë:
Të ilustrojnë një personazh nga libri që u ka pëlqyer më shumë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 18

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vija dhe vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh llojet e vijave dhe kupton përdorimin e tyre në vepra arti.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.7, II.8, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.3,2.1.



Llojet e vijave në art

Në vepra arti, ekzistojnë 5 lloje kryesore të vijave: *vertikale, horizontale, diagonale, zigzage* dhe *të lakuara.*

Vijat vertikale janë vija të drejta nga lart - poshtë.

Vijat horizontale janë vija paralele në horizont që lëvizin nga e majta në të djathtë.

Vijat diagonale janë vija të drejta që shkojnë nga çdo drejtim përveç horizontales dhe vertikales.

Vijat zigzage janë vija diagonale që bashkohen në skaje.

Vijat e lakuara janë vija që përkulen dhe ndryshojnë drejtim. Ato mund të jenë me dredha ose spirale.

42

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e vijave në art

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shpreh mendime për llojet e vijave;
- Dallon llojet e vijave sipas formës, trashësisë, pozitës;
- Vizaton vija të ndryshme duke u bazuar në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lapsi, goma, fletë të bardha, projektori, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Njeriu dhe natyra, Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë muzikore, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u parashtrohen disa pyetje, si:
-Për çfarë na ndihmojnë vijat? (Për të shkruar shkronjat, numrat; për të vizatuar natyrën, kafshët, njerëzit dhe gjësende të ndryshme).
-Çfarë lloje të vijave kemi? (Të drejta, të lakuara, të holla, të trasha).

Paraqitet në projektor një video ku demonstrohet vizatimi i një vazoje me lule.
(Linku: https://youtu.be/7UqmYBsA6dQ).
Në mungesë të projektorit mësuesja e demonstron në tabelë vizatimin e një vazoje me lule.

Hapi 2: Demonstrohen duke i vizatuar në tabelë llojet e vijave që përdoren në art.
Vijat vertikale janë vijat poshtë-lartë.

Fletë pune

Dalloj vijat në vepra arti

1. Analizo veprën dhe vendos ✓ për llojet e vijave që përmban.

Vijat vertikale

Vijat horizontale

Vijat diagonale

Vijat zigzage

Vijat e lakuara

2. Krijo punimin tënd me llojet e vijave që mësove.

43

Vijat horizontale lëvizin nga e majta në të djathtë.
Vijat diagonale shkojnë në çdo drejtim përveç horizontales dhe vertikales.
Vijat zigzage, të lakuara, me dredha.
Vijat e holla dhe të trasha.
Nxënësit dallojnë llojet e vijave në tekst.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të analizojnë llojet e vijave në vizatim duke vendosur llojet e vijave që janë përdorur.
Udhëzohen të krijojnë punimin e tyre me llojet e vijave që i mësuan.

Hapi 4: Nxënësit prezantojnë punimet para klasës.
Emërtojnë llojet e vijave që i kanë vizatuar.
Reflektojnë për vijat e mësuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin gjatë diskutimit për llojet e vijave, për saktësinë në vizatimin dhe emërtimin e tyre.

Detyrë:
T'i vizatojnë llojet e vijave, më pas t'i ngjyrosin ato.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vija dhe vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Kupton rëndësinë e vizatimit dhe e përdor në praktikë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

Rëndësia e vizatimit dhe përdorimi në praktikë

Ilustrim filmi

Për ta realizuar një film të animuar, filloj nga vizatimi. Pasi e lexoj skenarin e filmit, realizoj skemën e ngjarjeve. Pra, skenari ndahet në skena, të cilat i vizatoj njësoj si ilustrimet e librave.

Ilustrim libri

Në librat që ne lexojmë, shohim ilustrime të ndryshme. Prandaj, para se të botohet libri, ilustruesi i vizaton dhe ilustron të gjitha personazhet dhe ngjarjet e librit.

Arkitektura fillon me vizatimin e peizazhit ku do të ndërtohet; hidhen skicat e objektit me laps e më pas realizohet edhe në kompjuter.

44

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rëndësia e vizatimit dhe përdorimi në praktikë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton rreth ilustrimeve në libra;
- Vizaton dhe ngjyros personazhin e preferuar të përrallave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, libra me ilustrime, lapsi, ngjyrat etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në klasë sillen disa libra të përrallave me ilustrime. Paraqiten para nxënësve ilustrimet e përrallave, si: Kësulëkuqja, Borëbardha, Pinoku etj.
Nxënësve u tregohet që në një libër për fëmijë, rëndësi të madhe kanë figurat. Prandaj, para se të botohet libri, ilustruesi i vizaton dhe ilustron të gjitha personazhet dhe ngjarjet e librit.

Hapi 2: Sqarohet se për të realizuar një film të animuar, fillohet nga vizatimi. Skenari ndahet në skena dhe vizatohen njëlloj si ilustrimet e librave.
Gjithashtu, duke vizatuar krijohen personazhet e filmit.

Më pas kërkohet nga nxënësit që të vizatojnë dhe të ngjyrosin një personazh nga përrallat me ilustrime.

Fletë pune Vizatojmë

1. Vizato një personazh nga filmat vizatimorë.

2. Vizato një personazh libri.

3. Vizato tavolinën e punës.

45

P.sh. Pinoku.

Hapi 3: Nxënësve u shpjegohet se arkitektura fillon me vizatimin e peizazhit ku do të ndërtohet, hidhen me laps skicat e objektit e më pas kompjuterizohet.

Hapi 4: Hapen librat, lexohet teksti me ndalesa.

Pas çdo leximi komentohet pjesa e lexuar, kështu nxënësit do të kuptojnë më mirë rëndësinë e përdorimit të vizatimit në praktikë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin aktiv rreth temës, për saktësinë në vizatimin dhe ngjyrosjen e personazhit të përrallës.

Detyrë:
Të plotësohet fq. 45.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 20

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vija dhe vizatimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Tregon së paku 2 shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të vijave të lira ose gjeometrike (orendi të brendshme ose në natyrë).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, II.1, II.4, II.7, III.1, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.

Vijat gjeometrike

Vijat gjeometrike i shoh kudo, në shtëpi e në natyrë.
Format gjeometrike në shtëpi i shoh te lodrat, librat, mobiliet, dritaret etj.
Në natyrë, mund t`i shoh format gjeometrike te gjethet, kërcelli, hojet e mjaltit, lisat etj.

Në shtëpi, forma gjeometrike të ndryshme ka në dyer, në tavolina, në tepih.

Provo edhe ti të vëzhgosh përreth.
Cilat vija dallove?
Ku?

46

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vijat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton vija të ndryshme duke bashkuar pikat;
- Dallon format e orendive të brendshme dhe në natyrë;
- Ngjyros motivet popullore sipas shembullit në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune me pika, lapsi, goma, ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletë pune ku janë të vendosura disa figura gjeometrike me pika. Udhëzohen t'i bashkojnë pikat. Pas bashkimit të tyre do të fitojnë figura të ndryshme gjeometrike.
Parashtrohen pyetjet për gjërat që gjenden në klasë:
Ku gjenden lodrat ? Ku gjenden dritaret? Tabela? (brenda në klasë).
Parashtrohen pyetjet për gjërat që ndodhen në natyrë:
Ku gjenden pishat? Ku gjenden fushat? Ku gjenden malet? Lumenjtë? (jashtë në natyrë).
Të gjitha këto kanë forma të caktuara të cilat mund t vizatohen me vija të ndryshme.



Fletë pune Imitoj me vija gjeometrike - qilimi

1. Ngjyros këtë qilim.
Në klasë, me ndihmën e mësuesit/es, mund të vizatosh dhe të ngjyrosësh qilima të tjerë me motive popullore.

47

Hapi 2: Lexohet teksti nga mësimdhënësi/ja.
Bashkëbisedohet për vijat dhe format gjeometrike të cilat mund të shihen kudo në shtëpi dhe në natyrë.
Diskutohen fotot me orendi të brendshme dhe në natyrë që janë të vendosura në tekst (dera, dritarja, tavolina, gjethi).
Parashtrohen pyetjet:
Çfarë vija kanë përdorur për t'i vizatuar ato? Për vizatimin e derës çfarë vija janë përdorur? Po për gjethin? Për tavolinën çfarë vija janë përdorur?

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit që të vizatojnë dhe të ngjyrosin qilimin me motive popullore sipas shembullit në libër.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit të vizatojnë dhe të ngjyrosin një motiv popullor sipas dëshirës.
Ata vizatojnë me ndihmën e mësueses edhe një motiv tjetër popullor.
Ja disa shembuj të motiveve popullore shqiptare.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për informatat kthyese me gojë, për përgjigjet që i japin për llojet e vijave, për saktësinë në vizatimin e motiveve popullore.

Detyrë:
Të krijojnë një punim me vija gjeometrike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 21

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Llojet e ngjyrave dhe teknikat

Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon ngjyrat bazë dhe përzierjen e ngjyrave të dyta.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.1, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 4.2.



Ngjyrat bazë dhe të përbëra

A e di se sa shumë ngjyra ka?
Ngjyrat i krijoj duke i bashkuar tri ngjyrat bazë: të verdhën, të kuqen dhe të kaltrën e mbyllur. Këto tri ngjyra quhen ngjyra bazë ose parësore.

E verdhë | E kuqe | E kaltër

Me përzierjen e tyre krijoj ngjyrat e përbëra ose dytësore. Shih më poshtë.

Duke përzier ngjyrën e verdhë me të kaltrën, fitojmë ngjyrën e gjelbër.

Duke përzier ngjyrën e kuqe me të verdhën, fitojmë ngjyrën e portokalltë.

Duke përzier ngjyrën e kuqe me të kaltrën, fitojmë ngjyrën vjollcë.

50

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjyrat bazë dhe të përbëra

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për ngjyrat duke i emërtuar ato;
- Dallon ngjyrat bazë nga ngjyrat e përbëra;
- Krijon ngjyra sipas modelit në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Piktura, libri, lapsi, goma,ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten ngjyrat e drurit para nxënësve.
Parashtrohen pyetjet:
A e di se sa shumë ngjyra ka?
Ylberi sa ngjyra ka? Cilat janë ato?
Dielli çfarë ngjyre ka? (Të verdhë).
Po molla? (Të kuqe).
Nxënësit vizatojnë ylberin me shtatë ngjyra dhe i emërtojnë ato.



Fletë pune

Krijoj ngjyra dhe ngjyros

1. Vendos ✓ në katrorët për ngjyrat bazë (parësore).

2. Lidh me ngjyrën e fituar.

a.

b.

c.

3. Zbulo dhe ngjyros.

4. Në bllokun e vizatimit, krijo pikturën tënde me ngjyrat e përbëra (dytësore).
Shkruaj se cilat ngjyra krijove:

51

Hapi 2: Shpjegohet nga mësimdhënësi/ja
Kemi dy lloje të ngjyrave:
Ngjyra bazë ose parësore dhe ngjyra të përbëra ose dytësore.
Ngjyrat bazë janë: e kuqe, e verdhë e kaltër.
Me përzierjen e ngjyrave bazë fitohen ngjyrat e përbëra.
Demonstrohet mënyra e përzierjes së ngjyrave në libër.
Lexohen udhëzimet nga teskti për përzierjen e ngjyrave.

Hapi 3: Nxënësit plotësojnë sipas kërkesave në tekst:

1. Vendos në katrorët për ngjyrat bazë (parësore);
2. Lidh me ngjyrën e fituar;
3. Zbulo dhe ngjyros;
4. Krijo pikturën tënde me ngjyrat e përbëra.

Hapi 4: Pikturat e punuara i vendosin në murin e klasës.
Shpjegojnë mënyrën e realizimit të pikturave dhe ngjyrat e përdorura.
Përzgjedhin punimin më të mirë duke vlerësuar njëri-tjetrin me shenjë + dhe -.
Punimi që merr më shumë pluse zgjidhet fitues.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin, për pikturat që i kanë vizatuar dhe për përzierjen e ngjyrave.
Vlerësohen me informata kthyese me shkrim (me fytyra të buzëqeshura) për pikturat e tyre.

Detyrë:
Të vizatojnë një pikturë sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Llojet e ngjyrave dhe teknikat

Rezultatet e të nxënit të temës: Kupton teknikën e akuarelit dhe ngjyros se paku dy punime (me ngjyra të ujit).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, I.3, II.4, II.8, III.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 4.2.

Ngjyrat e ujit ose akuarelet

Ngjyrat e ujit ose akuarelet janë ngjyra që shkrihen në ujë për të pikturuar.

I gjejmë në kuti ose tube.

Brushat e akuarelit duhet të jenë shumë të buta.

Të këshilloj: fillo të pikturosh duke nisur ngjyrosjen nga ngjyrat më të hapura, sepse janë të tejdukshme dhe nuk mund t'i mbulosh ngjyrat e errëta. Sa më e holluar me ujë të jetë boja, aq më e lehtë është ngjyra.

52

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjyrat e ujit ose akuarelet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton llojet e ngjyrave në sfond;
- Dallon ngjyrat e ftohta nga ngjyrat e ngrohta;
- Krijon ngjyrat e përziera nga ngjyrat bazë;
- Pikturon me ngjyra akuarele.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjyrat e ujit, vizatimi, peizazhe.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u paraqitet në projektor kënga "Ngjyrat", e cila gjendet në linkun:

https://youtu.be/ZZieAuB0CIM.

Nxënësit emërtojnë ngjyrat dhe këndojnë këngën që e dëgjojnë.
Në mungesë të projektorit nxënësve u paraqiten gjësende me ngjyra të ndryshme.
Shembull: Ngjyrat e drurit, ngjyrat e lapsit, e tabelës, e çantës, e dollapave, e murit, e dyerve, e dritareve etj.
Parashtrohen pyetje për ngjyrat e gjësendeve që i shohin.



Fletë pune Pikturoj me ngjyra uji (akuarele)

Përdor ngjyrat e ujit dhe pikturo peizazh dimri në bllokun tënd të vizatimit.
Pas krijimit të pikturës sate, prezantoje para klasës.
1. Shkruaj më poshtë përshtypjet e tua për punimin tënd.

2. Shkruaj përshtypjet e tua për punimin e shokut apo shoqes së klasës.

3. Shkruaj të veçantat dhe të përbashkëtat e punimit tënd me atë të shokut ose shoqes së klasës.

53

Hapi 2: Lexohet teksti nga mësimdhënesi/ja dhe demonstrohet për ngjyrat e ujit ose akuarelet, të cilat janë ngjyra që shkrihen në ujë për të pikturuar. Ato mund të gjenden në tube apo në kuti.

Hapi 3: Nxënësit dallojnë ngjyrat e ngrohta nga ngjyrat e ftohta në peizazhet që i paraqet mësimdhënësi në tabelë.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit të përdorin ngjyrat e ujit dhe të pikturojnë një peizazh dimri në bllokun e tyre të vizatimit.

Hapi 5: Pas krijimit të pikturës, e prezantojnë para klasës. Ndiqen këta hapa:

1. Shkruaj më poshtë përshtypjet e tua për punimin tënd.
2. Shkruaj përshtypjet e tua për punimin e shokut apo shoqes së klasës.
3. Shkruaj të veçantat dhe të përbashkëtat e punimit tënd me atë të shokut ose shoqes së klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen në bazë të emërtimit të ngjyrave, vlerësohen për punimet e bëra dhe për saktësinë e ngjyrosjes me ngjyrat e ujit (akuarele).

Detyrë:
Sipas dëshirës të vizatojnë dhe të ngjyrosin punimin me ngjyra akuarele.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Llojet e ngjyrave dhe teknikat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe përdor i mjetet e ngjyrosjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; II.4, III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.2.

Ngjyrat tempera

Po ashtu, më pëlqen të pikturoj edhe me ngjyra tempera, sepse lehtë mund të krijoj ngjyra të reja.

Ato i gjejmë në këto forma:

Ja se si duket një brushë e përshtatshme për të punuar me këto ngjyra:

Të këshilloj: kur përdor ngjyrat tempera, njëra nga teknikat është të hedhësh ngjyrën në pjesën e poshtme të brushës dhe ta përhapësh butë në letër. Po ashtu, me ngjyrën që të mbet në brushë, duhet të marrësh një ngjyrë tjetër dhe ta shpërndash butë në letër, që të krijosh një ngjyrë të re.

54

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjyrat tempera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon cilësitë e temperave;
- Ngjyros punimin me tempera;
- Përshkruan punimin e tij dhe të shokut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat tempera, fletë vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Rikujtohen bashkë me nxënësit njohuritë për temperat, si:





Fletë pune Pikturoj me tempera

Përdor ngjyrat tempera dhe pikturo kopshtin me lodra, në bllokun tënd të vizatimit.
Pas krijimit të pikturës sate, prezantoje para klasës.
1. Shkruaj më poshtë përshtypjet e tua për punimin tënd.

2. Shkruaj përshtypjet e tua për punimin e shokut apo shoqes së klasës.

3. Shkruaj të veçantat dhe të përbashkëtat e punimit tënd me atë të shokut ose shoqes së klasës.

55

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit që në bllokun e tyre të vizatimit me ngjyrat tempera të pikturojnë kopshtin me lodra.

I mbyllin sytë dhe e mendojnë natyrën, kopshtin e lodrave dhe çdo gjë që kanë dëshirë të kenë aty. Kur të jenë gati, i hapin sytë dhe fillojnë të vizatojnë atë pamje që e kanë përfytyruar.

Në hapësirë gjenden shumëllojshmëri formash, largësish ngjyrash. Në vizatim do të paraqesin objekte të formave të ndryshme që përbëjnë natyrën. I ngjyrosin ato sipas dëshirës. Pas krijimit të pikturës, i prezantojnë para klasës.

Hapi 3: Më pas hapen librat dhe nxënësit i shkruajnë përshtypjet për punimet e e tyre (detyra 2).

Pastaj vazhdohet edhe me detyrën 3, ku nxënësit do t'i shkruajnë përshtypjet e tyre për punimin e shokut apo shoqes së klasës.

Ndërsa në detyrën e fundit do të bëjnë krahasimin e punimit të tyre me punimin i shokut-shoqes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njohjen e cilësive të temperave, saktësinë e ngjyrosjes, përshkrimin dhe krahasimin e punimit të tyre dhe të shokëve.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 24

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Llojet e ngjyrave dhe teknikat

Rezultatet e të nxënit të temës: Krijon një kolazh me format gjeometrike dhe diskuton mënyrën e realizimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1., III.1,2, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.1, 4.1.

Fletë pune Krijoj kolazh me forma gjeometrike

1. Përdor ngjyra, fije bari, guriçka, oriz, lëvore druri, gjethe, degëza, rërë, pambuk etj. për të krijuar kolazhin tënd.

2. Shkruaj mënyrën e realizimit.

56

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijoj kolazh me forma gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për kolazhet e paraqitura;
- Punon materiale për kolazhe të ndryshme;
- Krijon kolazhe sipas imagjinatës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsi, ngjyrat, letër vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten në projektor disa kolazhe nga arti. (Në mungesë projektori paraqiten foto me kolazhe).

Parashtrohen pyetjet: Çfarë po shihni në foton 1? (Një vazo me lule).
Çfarë materiali është përdorur për gjethet e saj?
Si janë punuar petalet e saj? (Me lëvozhga nga ngjyrat).

Fletë pune Krijoj kolazh me forma gjeometrike

1. Përdor ngjyra, fije bari, guriçka, oriz, lëvore druri, gjethe, degëza, rërë, pambuk etj. për të krijuar kolazhin tënd.

2. Shkruaj mënyrën e realizimit.

56

Hapi 2: Shpjegohet termi "Kolazh" Është një vepër arti e bërë nga ngjitja e gjërave në sipërfaqe. Kolazh është një pjesë e artit që përfshin një sërë materialesh. Shpesh përfshin ngjitjen e gjërave si letra, rroba, gazeta, lëvozhga ngjyrash, pulla etj.
Udhëzohen nxënësit të përdorin ngjyra, fije bari, guriçka, oriz, lëvore druri, gjethe, degëza, rërë, pambuk etj. për të krijuar kolazhin e tyre.
Ngjitjen e bëjnë në fletë të bardha dhe në këtë mënyrë krijojnë kolazhin në libër.
Udhëzohen ta përshkruajnë me fjali mënyrën e realizimit të kolazhit duke analizuar materialet që kanë përdorur dhe si i kanë përdorur.

Përforcimi:
Konsolidim i të nxënit (Turi i galerisë)

Nxënësit ekspozojnë punimet e tyre në tabelë para klasës (kolazhe me gazeta, me lëvozhga të lapsave me ngjyra, pulla, letra me ngjyra etj.).
Reflektojnë për punimet duke i analizuar materialet që kanë përdorur dhe çfarë kanë paraqitur në ato punime kolazhi.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që japin për kolazhet, për saktësinë e shtypjes së materialeve (letër, gazetë) dhe krijimit të kolazheve sipas udhëzimeve në libër.

Detyrë:
Të krijojnë një kolazh sipas dëshirës në letër të bardhë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 25

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Llojet e ngjyrave dhe teknikat

Rezultatet e të nxënit të temës: Duke marrë shembuj të ndryshëm të komentojë përdorimin e ngjyrave në jetën e përditshme (flokët e individit, ngjyra e syve, veshjet, ambient i afërt, makinat, ndërtesat etj.).

Fletë pune Dalloj ngjyrat në pikturë

1. Vështro figurën me kujdes dhe dallo ngjyrat që janë përdorur.

Përshkruaj vajzën duke treguar ngjyrën e flokëve, të syve, të veshjes, si dhe ngjyrat e ambientit përreth.

57

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,II.1,II.8,III.1,III.3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,2.1,3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dalloj ngjyrat në pikturë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton llojet e ngjyrave sipas përbërjes;
- Diskuton për ngjyrat e pikturës së paraqitur në tekst;
- Vizaton dhe ngjyros shokun apo shoqen e klasës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletë me 4 portrete për ngjyrosje, ngjyrat e drurit, ngjyrat e ujit, flamasterat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Çka paraqitet për ngjyrosje të vizatimeve? (Ngjyrat).
Paraqiten para nxënësve disa lloje të ngjyrave:

Ngjyrat e drurit

Flamastera

Ngjyrat e ujit (akuarele)

Pyeten nxënësit: Si quhen këto ngjyra që i shohim? Me me ndihmën e mësueses emërtojnë ngjyrat që i shohin.

Fletë pune
Dalloj ngjyrat në pikturë

1. Vizato dhe ngjyros shokun apo shoqen tënde. Trego pastaj cilat lloje të ngjyrave përdore?

58

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit të vështrojnë figurën me kujdes dhe të dallojnë ngjyrat që janë përdorur.
Përshkruajnë vajzën duke treguar ngjyrën e flokëve, të syve, të veshjes, si dhe ngjyrat e ambientit përreth.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të lexojnë përshkrimet e tyre.

Hapi 4: Vizatojnë dhe ngjyrosin shokun apo shoqen e klasës.
Nxënësit udhëzohen që mos të dalin nga vija gjatë ngjyrosjes së portreteve në tekst.
Cilat lloje të ngjyrave përdore?
Pastaj i shkruajnë ato duke plotësuar në tekst.

Hapi 5: Ekspozojnë punimet e tyre në litarin për tharrje.
Pas ngjyrosjes pyeten nxënësit për ngjyrat që i kanë përdorur.
Ja disa shembuj të mundshëm: Çfarë ngjyre ke përdorur për shokun/shoqen? (Ngjyra bazë).
Çfarë ngjyre për sytë? (Të ngrohta), Po flokët? (Të përziera) etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin për llojet e ngjyrave, për saktësinë në ngjyrosjen e shokut/shoqes së klasës.

Detyrë:
Të vizatojnë dhe të ngjyrosin një figurë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 26

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Format dhe modelimi

Rezultatet e të nxënit të temës: Dallon madhësitë dhe këndin e shikimit të objekteve në hapësirë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4.



Forma dhe struktura

Objektet, si shtatorja e Skënderbeut ose ndërtesat e vjetra, kanë formë, vëllim dhe madhësi.
Po ashtu, kanë edhe strukturë të caktuar.
Ato, varësisht nga madhësia dhe vëllimi i tyre, kanë përbërje të ndryshme, si: hekuri, guri, druri, bronzi etj.

Shtatorja e Skënderbeut

Objekt i vjetër

Fotot që po shihni më poshtë tregojnë perspektivën; pra shohim se si një objekt mund të duket ndryshe, varësisht prej pozitës që e shohim:

60

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Forma dhe struktura

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon pamjen e objekteve në hapësirë;
- Vizaton objekte në hapësirë;
- Përshkruan punimin e tij.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, videoprojektori etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten me videoprojektor disa fotografi të perspektivës. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çka po shohin në fotografitë e paraqitura, si dhe çka kuptojnë me fjalën "perspektivë"?

Fletë pune Përshkruaj objekte

1. Përshkruaj një bust apo një vend historik në rrethin tënd.

61

Hapi 2: Nxiten nxënësit të përshkruajnë qytetin e tyre, duke përdorur edhe imagjinatën. Nëpërmjet figurave të paraqitura me videoprojektor vërehet vendodhja dhe përmasat e objekteve:

- Cila shtëpi është më larg?
- Cila shtëpi është më afër?
- Cila i ka përmasat më të mëdha?
- Cila i ka përmasat më të vogla?
- Pse objektet vijnë duke u zvogëluar?
- Cilin objekt shikojmë të parin dhe cilin të fundit?

Perspektiva lidhet me artin dhe për këtë arsye është arti i përfaqësimit të objekteve në pikturë. Perspektiva është teknikë arti për të krijuar një iluzion tridimensional. Perspektiva bën që një pikturë të duket si e "vërtetë" sepse paraqet formë dhe thellësi.

Hapi 3: Hapen librat, analizohen figurat.
Udhëzohen nxënësit që me 4-5 fjali ta përshkruajnë një bust apo një vend historik në rrethin tyre.

Hapi 4: Për dy-tre minuta nxënësit lihen të lirë të vëzhgojnë punimet e tyre. Secili përshkruan punën e vet, duke shpjeguar elementet e perspektivës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e pamjeve të objekteve në hapësirë, vizatimin dhe ngjyrosjen e saktë të objekteve në perspektivë dhe përshkrimin e punës së vet.

Detyrë:
Të vizatojnë sipas modelit të perspektivës në faqe 62.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 27

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Profesione dhe shkathtësi kreative

Rezultatet e të nxënit të temës:
Me teknikë të lirë kreative realizon 1 punim për profesionin e adhuruar duke komentuar mënyrën e realizimit dhe të përdorimit praktik.

Unë do të bëhem...

Çdoherë më pyesin:
- *Ç'do të bëhesh kur të rritesh?*
- *Cili nga profesionet të pëlqen? Pse?* etj.

Unë nuk kam përgjigje tani, por di një gjë, që secili prej nesh ka diçka që e bën shumë mirë. Kemi një talent. Për shembull, unë di të vizatoj dhe mendoj se do të bëhem piktor.

Po ti, çfarë di të bësh më mirë?

64

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.6, II.4, III.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë do të bëhem...

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton disa profesione të ndryshme;
- Vizaton profesionin e dëshiruar;
- Përshkruan me fjalë profesionin e vizatuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto sipas profesioneve, ngjyrat, lapsi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Shkathtësi për jetë, Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u parashtrohen disa pyetje, si:
-Çfarë dëshironi të bëheni kur të rriteni? (Mjek/e, polic/e, mësues/e etj.)
-Pse ju pëlqen ky profesion?
Nxënësit i shprehin mendimet e tyre.
Paraqiten disa foto me ilustrime me profesione të ndryshme. Diskutohen profesionet e preferuara.
Shkruhen disa nga emrat e tyre.
Shembull:



Fletë pune Vizatoj profesionin tim

1. Vizato diçka që lidhet me profesionin që ty të pëlqen.

2. Përshkruaj atë që vizatove.

3. Me cilën lëndë në shkollë ndërlidhet profesioni që ke vizatuar?

65

Hapi 2: Shpjegohet kuptimi i fjalës "profesion". Çdo punë që kryhet ka një emër ai quhet profesion.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të plotësojnë sipas kërkesave në tekst.

1. Vizato diçka që lidhet me profesionin që ty të pëlqen.
2. Përshkruaj me fjalë atë që vizatove.
3. Me cilën lëndë në shkollë ndërlidhet profesioni që ke vizatuar?

Hapi 4: Nxënësit do të orientohen që me anë të vizatimit të paraqesin profesionin që u pëlqen.
Ata do të shkruajnë edhe arsyen përse u pëlqen ai profesion.

Hapi 5: Nxënësit ngjyrosin profesionin e tyre me ngjyra të drurit.
Lexojnë disa nxënës për profesionet e tyre çfarë kanë vizatuar dhe pse e pëlqejnë atë profesion.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përzgjedhjet e profesioneve dhe në bazë të vizatimeve që i kanë kryer për profesionin e pëlqyer.

Detyrë:
Të vizatojnë profesionin e prindërve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 28

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Profesione dhe shkathtësi kreative

Rezultatet e të nxënit të temës: Kupton rëndësinë e komunikimit me masën (librat, gazetat, reklama, shenjat, TV, celularët, lojërat etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.1, III.2, III.4.

Komunikoj me të tjerët

Komunikimi dhe informimi i mirë dhe i shpejtë sot bëhet përmes: librit, televizorit, internetit, reklamave etj.

Lidh mjetet e komunikimit.

Gazeta
Televizori
Letra
Radioja
Revista
Libri
Kompjuteri

66

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Komunikoj me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon format e komunikimit me masën;
- Diskuton për llojet e komunikeve në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë për ngjyrosje, libri, lapsi, goma, ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet:

Çfarë dini për komunikimin? (Flasim, shprehim diçka, shkëmbejmë mendime).
Me çka komunikoni me të tjerët? (Me telefon).
Po me familjarët që i keni larg vendit? (Me kompjuter, telefon).

Plotësohet organizuesi grafik:

telefon kompjuter
gazeta Komunikimi letër
libra postë reklama



Fletë pune Mjeti im i komunikimit

1. Vizato mjetin e komunikimit që të pëlqen më shumë.

67

Hapi 2: Shpjegohet termi "komunikoj" , që do të thotë njoftoj, kumtoj diçka, po ashtu ka edhe kuptime të tjera, si: ndërlidhem, hyj në lidhje me dikë, komunikoj me shokun, shoqen, komunikoj me letra, telefon.
Komunikimi dhe informimi i mirë dhe i shpejtë sot bëhet përmes librit, televizorit, internetit, reklamave etj.
Nxënësve u kërkohet të lidhin mjetet e komunikimit mes vete , si për shembull:
gazetën me libra;
telefonin me kompjuter;
televizorin me radio.
Udhëzohen nxënësit të vizatojnë mjetin për komunikim që u pëlqen më tepër.

Hapi 3: Nxënësit përshkruajnë me fjalë çfarë kanë punuar;
çfarë vija kanë përdorur; përse u pëlqen ai mjet; cilin mjet e e kanë përdorur më tepër etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin gjatë diskutimeve, për saktësinë në punimin e mjetit të komunikimit.

Detyrë:
Të shkruajnë 5 fjali për mjetin e vizatuar të komunikimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 29

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Objekte dhe artefakte

Rezultatet e të nxënit të temës: Njeh dhe dallon objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.1, III.2.

Objekte dhe artefakte

Objektet dhe artefaktet e trashëgimisë kulturore

Trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe atë jomateriale, si bartëse e kujtesës historike dhe e identitetit kombëtar.
Objekte të trashëgimisë historike e kulturore janë: pikturat, fotografia, librat, dorëshkrimet, dokumentet historike, objektet arkeologjike, statujat etj.

Kalaja e Prizrenit

Parku Kombëtar i Butrintit

68

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Objektet dhe artefaktet e trashëgimisë kulturore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shpreh mendime për grupin e fjalëve "Trashëgimi kulturore";
- Dallon objektet e trashëgimisë kulturore;
- Përshkruan objektet trashëgimore në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pikturat, libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhët dhe komunikimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohet pyetja: Çfarë dini për trashëgiminë kulturore?

pikturat
objektet arkeologjike
dokumentet historike

Trashëgimia kulturore

fotografitë
dorëshkrimet

librat

statujat

Nxënësit shprehin mendime dhe me ndihmën e mësueses e plotësojnë kuptimin e fjalës së kërkuar.

Hyjnesha në fron

Një nga artefaktet që tregon historinë e vendit tonë është "Hyjnesha në fron", statujë e baltës, e mbretëreshës dardane. "Hyjnesha në fron" ruhet në Muzeun e Prishtinës.

Piramida e Gizës
(Egjipt)

Ndërsa, një nga objektet më të njohura të trashëgimisë së kulturave të huaja janë piramidat e Egjiptit.

69

Hapi 2: Shpjegohet çka përfshin trashëgimia kulturore.
Ajo përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale si bartëse e kujtesës dhe identitetit kulturor.
Nxënësit njihen me objektet e trashëgimisë kulturore, siç janë: librat, dorëshkrimet, objektet arkeologjike, statuja, piktura, fotografia etj.

Hapi 3: Nxënësit pyeten: Çfarë po shihni në fotot në tekst?
Bashkëbisedohet me nxënësit për secilën foto: për Parkun Kombëtar të Butrintit, kalanë e Prizrenit, piramidën e Gizës, piramidën e Egjiptit, Hyjneshën në fron etj.

Hapi 4: Udhëzohen të vizatojnë dhe të përshkruajnë me fjalë objektet e trashëgimisë kulturore që i shohin në libër.

Hapi 5: Nxënësit lexojnë shkrimet për objektet e trashëgimisë kulturore, si:
Kalanë e Prizrenit, Parkun Kombëtar të Butrintit etj.
Diskutohet për "Hyjneshën në fron".

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin për objektet e trashëgimisë kulturore, për përshkrimin e objekteve të trashëgimisë kulturore nga libri.

Detyrë:
Të punojnë me plastelinë "Hyjneshën në fron" sipas shembullit në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 30

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Projekte dhe shembuj

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh disa nga objektet arkitekturale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.4; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1.

Projekte dhe shembuj | Shtatë mrekullitë e botës

Ke dëgjuar për *Shtatë mrekullitë e botës?*

Objektet më të njohura nga arkitektura botërore njihen si *Shtatë mrekullitë e botës.*

Taxh Mahall, Indi | Petra, Jordani | Koloseumi i Romës, Itali | Çiçen Itza, Meksikë

Maçu Piçu, Peru | Monumenti i Krishtit, Brazil | Muri i Madh Kinez, Kinë

70

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shtatë mrekullitë e botës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për arkitekturën;
- Njeh disa nga objektet më të njohura nga arkitektura botërore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit motivohen të shprehin sa më shumë mendime rreth fjalës "arkitekturë".



Projekte dhe shembuj | Shtatë mrekullitë e botës

Ke dëgjuar për *Shtatë mrekullitë e botës?*

Objektet më të njohura nga arkitektura botërore njihen si *Shtatë mrekullitë e botës.*

Taxh Mahall, Indi | Petra, Jordani | Koloseumi i Romës, Itali | Çiçen Itza, Meksikë

Maçu Piçu, Peru | Monumenti i Krishtit, Brazil | Muri i Madh Kinez, Kinë

70

Hapi 2: Pyeten nxënësit nëse kanë dëgjuar ndonjëherë për Shtatë mrekullitë e botës.
Me këtë emërtim njihen objektet më të njohura të arkitekturës botërore.
Paraqiten me videoprojektor fotografitë e këtyre objekteve, pastaj njoftohen për secilin nga pak, duke i parashtruar edhe disa pyetje, si:

- Ku ndodhen?
- Si janë ndërtuar?
- Kur?

Muri i Madh i Kinës - është një seri fortifikimesh prej guri dhe prej balte në veri të Kinës, i ndërtuar fillimisht për të mbrojtur kufijtë veriorë të Perandorisë Kineze kundër ndërhyrjeve nga grupe të ndryshme nomade. Disa mure janë ndërtuar që nga shekulli i 5, e janë përmendur së bashku si Muri i Madh, i cili është rindërtuar dhe mirëmbajtur nga shekulli i 5 para Krishtit deri në shekullin e 16.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen t'i analizojnë në libër objektet më të njohura nga arkitektura botërore.

Përshkruajnë me pak fjalë secilin prej tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin aktiv rreth temës dhe për njohjen e disa nga objektet më të njohura të arkitekturës botërore.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 31

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Projekte dhe shembuj

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh disa nga objektet arkitekturale

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.4; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1.


Projekte dhe shembuj | Skica e planimetrisë

Ndërtuesit e shtëpive, shkollave, rrugëve etj. në fillim bëjnë një skicë të saktë të tyre, që të përcaktojnë se si do të duken ato. Kjo skicë quhet *skicë e planimetrisë*. Ja se si duket një e tillë:

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Skica e planimetrisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për arkitekturën;
- Vizaton dhe ngjyros planimetrinë e shkollës;
- Vlerëson punën e shokut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxiten nxënësit të flasin rreth arkitekturës, duke i shikuar fotografitë e ndërtesave dhe hapësirave të ngjitura në tabelë:
- Çfarë shihni në tabelë?
- A dallojnë ato nga njëra-tjetra?
- Pse dallojnë ato?
- Si ndërtohet një ndërtesë?

Hapi 2: Nxënësve u shpjegohet se ndërtuesit e shtëpive, të shkollave, të rrugëve etj. në fillim bëjnë një skicë të saktë të tyre, që të përcaktojnë se si do të duken ato.

Kjo skicë quhet skicë e planimetrisë.



Fletë pune Projektoj shtëpinë time

Provo të vizatosh planimetrinë e shtëpisë që ke dëshirë ta kesh kur të rritesh.
Kujdes: vizatimi i planimetrisë duhet të jetë i saktë dhe i qartë. Përdor vizoret dhe lapsin teknik.

72

Shpjegohen dhe vizatohen në tabelë të gjitha mjediset e shkollës, kufizimi i tyre me njëri-tjetrin, klasat, korridoret etj.
Bëhet modeli i planit të shkollës në tabelë dhe nxënësit orientohen me anë të përmasave të dhëna me cm dhe vizore.

Hapi 3: Punimet e realizuara vendosen në këndin e klasës, diskutohet për punën e bërë.

Parashtrohen pyetjet:
- Si e realizove punimin?
- A pate vështirësi ta realizoje planimetrinë e shkollës?
- Po ngjyrosjen?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin aktiv rreth temës, vizatimin dhe ngjyrosjen e planimetrisë së shkollës dhe për vlerësimin e punës së shokut-shoqes.

Detyrë:
Provojnë ta vizatojnë planimetrinë e shtëpisë që kanë dëshirë ta kenë kur të rriten.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 32

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Projekte dhe shembuj

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor ornamente qilimash
për një projekt ideor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3, I.4, II.7, III.1, III.2, III.3, V.5.


Fletë pune Krijoj me motive qilimi

Qilimat shqiptarë kanë motive dhe ngjyra të larmishme.
Në foton e mëposhtme keni pjesë të ndryshme për t'i prerë. Pritini dhe krijoni një figurë sipas dëshirës.

73

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijoj me motive qilimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për qilimat e paraqitur në foto;
- Krijon motiv me ngjyra sipas shembullit në libër;
- Pret motivet nga libri duke krijuar motive të reja qilimash.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, filmi, fletët e bardha, ngjyrat, lapsi, goma.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë muzikore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten disa foto me motive popullore të qilimave shqiptarë. Mund të përdoren edhe motivet popullore të punuara nga nxënësit te njësia "Orendi të brendshme dhe në natyrë".



Fletë pune Krijoj me motive qilimi

Qilimat shqiptarë kanë motive dhe ngjyra të larmishme.
Në foton e mëposhtme keni pjesë të ndryshme për t'i prerë. Pritini dhe krijoni një figurë sipas dëshirës.

73

Hapi 2: Shpjegohet termi "qilim" - shtrojë e endur leshi, pambuku që shtrohet mbi dysheme.
Përdoren disa qilima për demonstrim të punimeve të tyre.
(Në mungesë të tyre paraqiten në projektor ose në letër).

Hapi 3: Në foton e mëposhtme ka pjesë të ndryshme për t'u prerë.
E presin dhe e krijojnë një figurë sipas dëshirës.
Nxënësit krijojnë me motive popullore qilima sipas dëshirës (ose shembullit nga libri).

Hapi 4: Udhëzohen të vetëvlerësojnë punimet e veta me ngjyrat e semaforit:

e kuqe – jo mirë; e verdhë – mirë; e gjelbër – shkëlqyeshëm.

Përzgjidhet punimi më i votuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet që i japin gjatë diskutimit, për cilësinë e punimeve të krijuara nga libri dhe për motivet e përdorura.

Detyrë:
Të vizatojnë një qilim sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 33

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Galeri dhe ekspozime

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturoro-artistike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; I.5, II,3.

Galeri dhe ekspozime | Institucionet kulturore

Institucionet kulturore pasqyrojnë trashëgiminë kulturore të një vendi.
Që të di më shumë për historinë e një vendi, vizitoj muzetë dhe vendet arkeologjike.
Ndërsa, që ta njoh kulturën artistike, vizitoj teatrot, galeritë etj.

Vizito apo hulumto në internet për një galeri dhe përshkruaje punën e ekspozuar në të.

75

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Institucionet kulturore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për institucionet kulturore;
- Klasifikon disa institucione kulturore-artistike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, plastelina, fletë kartoni etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet:
- Keni dëgjuar ndonjëherë për institucionet kulturore?
- Çka dini për to?
- Keni vizituar ndonjëherë ndonjë muze?
- Po teatër?
- Çfarë ju ka lënë përshtypje?

Hapi 2: Paraqiten me projektor disa galeri të artit, muze, teatër etj.
Analizohen fotografitë; tregojnë llojet e institucioneve, bëjnë krahasimin e tyre.
Nxënësit duke diskutuar klasifikojnë institucionet kulturore që tregojnë historinë e një vendi, si: vendet arkeologjike dhe muzetë, si dhe institucionet kulturore që tregojnë kulturën artistike, si: teatrot, galeritë etj.

Galeri dhe ekspozime

Institucionet kulturore

Institucionet kulturore pasqyrojnë trashëgiminë kulturore të një vendi.
Që të di më shumë për historinë e një vendi, vizitoj muzetë dhe vendet arkeologjike.
Ndërsa, që ta njoh kulturën artistike, vizitoj teatrot, galeritë etj.

Vizito apo hulumto në internet për një galeri dhe përshkruaje punën e ekspozuar në të.

75

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit të kategorizojnë institucionet kulturore, si:

Institucionet kulturore që tregojnë histori	Institucionet kulturore që tregojnë kulturë artistike
Muze	Teatro
Vende arkeologjike	Galeri
Statuja	Kinema

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin për institucionet kulturore dhe klasifikimin e tyre.

Detyrë:
Të vizitojnë një galeri dhe të përshkruajnë punën e ekspozuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 34

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Galeri dhe ekspozime

Rezultatet e të nxënit të temës: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, I.5, I.6.

Galeri dhe ekspozime

Krijuesit shqiptarë

Muslim Mulliqi - puna e tij karakterizohet nga përdorimi i guximshëm i ngjyrave, ritmi i fortë, hapësira e pafund etj.

Ibrahim Kodra - njihet si piktori më i rëndësishëm shqiptar.

Zake Prelvukaj - është një prej piktoreve më të njohura të vendit tonë.

76

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijuesit shqiptarë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për disa krijues shqiptarë;
- Tregon vlerën e artit;
- Përshkruan me shkrim vizatimin e kryer.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, videoprojektori etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten me videoprojektor disa fotografi të krijuesve shqiptarë. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se a i njohin personat në fotografi. Nëse po, të tregojnë se çfarë kanë dëgjuar për ta.

Galeri dhe ekspozime

Krijuesit shqiptarë

Muslim Mulliqi - puna e tij karakterizohet nga përdorimi i guximshëm i ngjyrave, ritmi i fortë, hapësira e pafund etj.

Ibrahim Kodra - njihet si piktori më i rëndësishëm shqiptar.

Zake Prelvukaj - është një prej piktoreve më të njohura të vendit tonë.

76

Hapi 2: Paraqiten krijimet e artistëve shqiptarë, si:

Muslim Mulliqi - puna e tij karakterizohet nga përdorimi i guximshëm i ngjyrave, ritmi i fortë, hapësira e pafund.

Ibrahim Kodra - njihet si piktori më i rëndësishëm shqiptar.

Nxënësit vlerësojnë krijimet e artistëve shqiptarë, p.sh:
Më pëlqen shumë peizazhi ose portreti; më pëlqen kombinimi i ngjyrave; teknika e përdorur; modelimi; mjetet me të cilat janë punuar.

Hapi 3: Më pas, nxënësit, duke u inspiruar nga krijuesit e artit, udhëzohen të tregojnë talentin e tyre duke punuar një vizatim sipas dëshirës, me teknikën e pëlqyer.

Hapi 4: Në fund zgjidhen 3 ose 4 punimet më të bukura, të cilat do të vendosen në ekspozitën e shkollës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, vlerësimin e krijimeve artistike, për përkushtimin e tyre për të punuar.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 35

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Analiza e punimeve

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan punën e ekspozuar në një galeri qyteti, shkolle, apo ekspozimi virtualo-elektronik në një faqe interneti.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.1, III.2, IV.2.

Analiza e punimeve | Ekspozita e parë

Edhe pak ditë kanë mbetur që të përfundojë klasa e dytë. Ju tani keni krijuar ekspozitën tuaj të parë.
Zgjidh dy punimet e tua më të bukura artistike dhe bisedoni për to në klasë.
Përdor këto pyetje:
- *Pse zgjodhe këto punime?*
- *Cilat vija ke përdorur?*
- *Çfarë ngjyrash përdore më shumë, të ngrohta apo të ftohta?*
- *Cilat forma ke përdorur?*
- *Si titullohen punimet e tua?*

Së bashku, ndani punimet e klasës në grupe.
Vizatime me lloje të ndryshme të vijave;
Vizatime me përdorim të mjeteve dhe teknikave të ndryshme të vizatimit;
Pikturë me mjete dhe teknika të ndryshme pikture;
Krijime të kombinuara me forma natyrale e gjeometrike;
Vizatime dekorative me vija, pika dhe forma gjeometrike;
Piktura duke përdorur ngjyra të forta (të ndezura);
Punim me akuarele etj.

Pasi t'i keni ndarë punimet në grupe, me ndihmën e mësuesit/es, vendosni punimet në klasë dhe ftoni prindërit ta shohin ekspozitën tuaj.

77

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.2, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekspozita e parë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përzgjedh një punim për ekspozitë në klasë;
- Ekspozon punimet e përzgjedhura;
- Diskuton për punimet e ekspozuara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Punimet e nxënësve, kartoni, lapsi, libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit përzgjedhin nga një vizatim (punim) për ekspozitë.
Parashtrohen pyetjet dhe diskutohet me nxënësit.

- Pse i zgjodhe këto punime?
- Cilat vija ke përdorur?
- Ngjyrat e ngrohta apo të ftohta i ke përdorur më shumë?
- Cilat ngjyra i krijove dhe i përdore në punimet e tua?
- Cilat forma ke përdorur?
- Si titullohen punimet e tua?



Analiza e punimeve | Ekspozita e parë

Edhe pak ditë kanë mbetur që të përfundojë klasa e dytë. Ju tani keni krijuar ekspozitën tuaj të parë.
Zgjidh dy punimet e tua më të bukura artistike dhe bisedoni për to në klasë.
Përdor këto pyetje:

- *Pse zgjodhe këto punime?*
- *Cilat vija ke përdorur?*
- *Çfarë ngjyrash përdore më shumë, të ngrohta apo të ftohta?*
- *Cilat forma ke përdorur?*
- *Si titullohen punimet e tua?*

Së bashku, ndani punimet e klasës në grupe.
Vizatime me lloje të ndryshme të vijave;
Vizatime me përdorim të mjeteve dhe teknikave të ndryshme të vizatimit;
Pikturë me mjete dhe teknika të ndryshme pikture;
Krijime të kombinuara me forma natyrale e gjeometrike;
Vizatime dekorative me vija, pika dhe forma gjeometrike;
Piktura duke përdorur ngjyra të forta (të ndezura);
Punim me akuarele etj.

Pasi t'i keni ndarë punimet në grupe, me ndihmën e mësuesit/es, vendosni punimet në klasë dhe ftoni prindërit ta shohin ekspozitën tuaj.

77

Hapi 2: Shpjegohet termi "ekspozitë" - vendi, salla ku vendosen punime
Udhëzohen nxënësit në grupe t'i mbledhin vizatimet e tyre sipas shembullit:
Vizatime me lloje të ndryshme të vijave;
Vizatime me përdorim të mjeteve dhe teknikave të ndryshme të vizatimit;
Pikturë me mjete dhe teknika të ndryshme pikture;
Krijime të kombinuara me forma natyrale e gjeometrike;
Vizatime dekorative me vija, pika dhe forma gjeometrike;
Piktura duke përdorur ngjyra të forta (të ndezura);
Punim me akuarel etj.

Punimet e nxënësve vendosen në një kënd të klasës.
Rregullohen sipas udhëzimeve të mësueses.

Hapi 3: Turi i galerisë
Diskutohen punimet e përzgjedhura nga nxënësit.
Ata e luajnë rolin e vizitorit.
Nxënësit vlerësojnë punimin që u pëlqen me shenjën (+).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet që i japin me informata kthyese me gojë. Vlerësohen për punimet e përzgjedhura me shenja motivuese (yje, fytyra të buzëqeshura) etj.

Detyrë:
Të vizatojnë nga një punim për ta ekspozuar në klasë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 36

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Vlerësimi individual

Rezultatet e të nxënit të temës: Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative të punimeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; III.1.



Vlerësimi individual | Vlerësoj veprat e njohura

"Motra Tone"
Kjo është vepra e njohur e piktorit të mirënjohur shqiptar, Kolë Idromenos.

Përshkruaj veprën me dy fjali.

"Nata yjore"
Ndërsa, vepra e dytë është e piktorit të njohur botëror, Vincent Van Gogh.

Përshkruaj veprën me dy fjali.

78

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësoj veprat e njohura

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për temën në mënyrë aktive;
- Vlerëson veprat artistike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, fletë a4, lapsa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet:
- Çka kuptoni me fjalën vlerësim?
- Si bëhet vlerësimi i veprave artistike?
- Në çka duhet të bazohemi për t'i vlerësuar ato?
- Keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë vepër artistike? Si quhet ajo?

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat, t'i analizojnë dhe vlerësojnë dy veprat e njohura, si: Motra Tone - (Kolë Idromeno).

Piktura paraqet një grua nga qyteti i Shkodrës, e re, e veshur me kostum popullor, me fytyrë e duar plot jetë, me një vështrim të ndrojtur, por krenar. Ajo është mbështjellë me napë të bardhë transparente, rrethuar me veshje të qëndisura e të zbukuruara.

Vlerësimi individual

Vlerësoj veprat e njohura

"Motra Tone"
Kjo është vepra e njohur e piktorit të mirënjohur shqiptar, Kolë Idromenos.

Përshkruaj veprën me dy fjali.

"Nata yjore"
Ndërsa, vepra e dytë është e piktorit të njohur botëror, Vincent Van Gogh.

Përshkruaj veprën me dy fjali.

78

Hapi 3: Njëjtë veprohet edhe me pikturën e dytë "Nata e Yjeve", e cila është e piktorit më të njohur në botë, Vincent Van Gogh.

Udhëzohen nxënësit që t'i përshkruajnë ngjyrat e ftohta të përdorura në pikturë, e kaltra e errët e qiellit, e verdha e ndritshme e yjeve, e bardha e hënës etj.

Më pas do të lexohen disa prej përshkrimeve të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për aktivizimin në diskutim dhe mënyrën e vlerësimit të veprave artistike.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 37

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë figurative
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Përshkrimi i punimeve

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përshkrimi i punimeve me shkrim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.3; I.5, II,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.2.



Përshkrimi i punimeve | Punime impresioniste

Shpeshherë impresionizmin e gjej në pikturat e: Claude Monet, Van Gogh, Renoir etj.

"Impression, Sunrise" - Claude Monet

Por, edhe në galeritë e ndryshme vendore dhe botërore, të cilat i vizitoj me familjen time.

Shkruaj për punimet që ty të pëlqejnë më shumë.

79

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Punime impresioniste

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Diskuton për temën
- Përshkruan me shkrim vizatimin e vet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 2, lapsi, ngjyrat, fletë a4 etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpjegohet koncepti i fjalës "impresionoj", që do të thotë - bëj që dikush të ndiejë drejtpërdrejt përshtypjet e çastit dhe t'u besojë atyre, ndikoj mbi ndjenjat e mendimet e tij.
Shpeshherë impresionizmin e gjejmë te personazhet e filmave vizatimorë, ose edhe në galeritë e ndryshme vendore dhe botërore.

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit që duke menduar për mënyrën e impresionimit të vet për artin, të përpiqen të punojnë si një artist i vërtetë. Më pas, ta përshkruajnë punën tuaj.

Hapi 3: Shpërndahen fletët a4, të cilat janë të ndara në dy pjesë, ku anën e majtë të fletës nxënësit do të vizatojnë një vizatim sipas dëshirës, ndërsa në anën e djathtë bëhet përshkrimi i punimeve me shkrim, së paku me dy-tri fjali.



Përshkrimi i punimeve

Punime impresioniste

Shpeshherë impresionizmin e gjej në pikturat e: Claude Monet, Van Gogh, Renoir etj.

"Impression, Sunrise" - Claude Monet

Por, edhe në galeritë e ndryshme vendore dhe botërore, të cilat i vizitoj me familjen time.

Shkruaj për punimet që ty të pëlqejnë më shumë.

79

Hapi 4: Punimet e nxënësve vendosen mbi tavolinë. Nxiten që të flasin rreth punimeve të tyre dhe të shokëve.

- Çfarë ke vizatuar ti? (Pjesëtarët e familjes sime, veten, mamin, babanë, vëllanë, motrën).

Nxënësit përshkruajnë me disa fjali dy punimet që kanë ndikuar në zhvillimin e tyre artistik.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin rreth temës dhe për vizatimin dhe përshkrimin e tij.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore: